



Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar nënshkruajnë marrëveshje në fushën e mbrojtjes, investimeve dhe marrëdhënieve industriale



» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MORI PJESË NË TAKIMIN E KOMITETIT USHTARAK TË NATO-S

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash Shtabi, në Bruksel, Belgjikë. Shefat e Shtabeve të NATO-s, në këtë takim të dytë për këtë vit, trajtuan një sërë çështjesh në lidhje me mbrojtjen kolektive dhe...



faqe 2



67 VITE KMS, HISTORI, KRENARI DHE PËRKUSHTIM NË SHËRBYM TË SIGURISË KOMBËTARE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me rastin e 67-vjetorit të krijimit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak në vend, kemi kënaqësinë të sjellim një intervistë ekskluzive me Komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj...



faqe 4



SOT BAZË E NATO-S, 70 VITE NGA KRIJIMI I REGJIMENTIT TË PARË TË AVIACIONIT USHTARAK SHQIPTAR NË KUÇOVË

Baza e Kuçovës është reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë. Data 15 maj e vitit 1955 është dita e krijimit të regjimentit, ligjësuar pas vendim të Kuvendit Popullor nr.81, datë 06.11.1956. Regjimenti përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktive MIG-15, të cilët...



faqe 6

Gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash Shtabi, në Bruksel, Belgjikë.

Shefat e Shtabeve të NATO-s, në këtë takim të dytë për këtë vit, trajtuan një sërë çështjesh në lidhje me mbrojtjen kolektive dhe qasjen ndaj sfidave të sigurisë. Diskutimet u fokusuan tek zhvillimet në mjedisin e sigurisë, u riafirmua kohezioni i Aleancës dhe masat për shkurajimin dhe mbrojtjen, zhvillimi i kapaciteteve dhe qasja proaktive për adresimin e krizave, vijimi i mbështetjes për Ukrainën dhe efikasiteti i operacioneve, misioneve dhe aktiviteteve të drejtuara nga Aleanca.

Një çështje tjetër me rëndësi në këtë takim, ishte nevoja e rritjes së investimeve në mbrojtje dhe inovacion, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të kërkuara për arritjen e efekteve të shkurajimit dhe mbrojtjes. Në ndërhyrjen e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji konfirmoi angazhimin e FARSH-së për vijimin e modernizimit të Forcave tona të Armatosura për zhvillimin e kapaciteteve, si dhe vendosmërinë e vendit tonë në vijimin e mbështetjes së masave të shkurajimit dhe mbrojtjes kolektive. Më tej, gjenerallejtënant Kingji ndaloi tek rëndësia e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, si dhe mbështetjen e modernizimit dhe transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komiteti Ushtarak i Shefave të Shtabeve është autoriteti më i lartë ushtarak i NATO-s, që këshillon Këshillin e Atlantikut të Veriut.



“Mbrojtësi i Epokës së Re – Defender ’25”, starton më 25 maj në Shqipëri

është demonstrimi i aftësisë për të dislokuar me shpejtësi trupa dhe pajisje nga Amerika e Veriut drejt Evropës, në një mjedis të ndërlikuar operativ.

“Defender Evropë 25” do të demonstronjë angazhimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj aleatëve dhe partnerëve tanë në NATO-s, si dhe një mundësi për të treguar gatishmërinë e Forcave tona të Armatosura për të shërbyer në krah të partnerëve tanë strategjikë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Evropë.

Kjo stërvitje përfaqëson një mesazh të qartë ndaj çdo kundërshtari të mundshëm: NATO është e bashkuar, e përgatitur dhe e gatshme të mbrojë çdo centimetër të territorit të saj. Në të njëjtën kohë, ajo synon të sigurojë opinionin publik në vendet aleate se përkushtimi i SHBA-së dhe NATO-s për sigurinë euroatlantike mbetet i palëkundur. Në vitin 2023, Shqipëria ishte një nga vendet pritëse të stërvitjes së madhe shumëkombëshe DEFENDER ’23, e cila u zhvillua nën drejtimin e Komandës Evropiane të SHBA-së. Kjo stërvitje përfshiu rreth 26,000 trupa nga 25 vende aleate dhe partnere, me aktivitete që u shtrinë në 10 vende evropiane, përfshirë Shqipërinë.

Në Shqipëri, DEFENDER ’23’ përfshiu operacione të rëndësishme logjistike dhe taktike, duke demonstruar aftësinë e SHBA-së dhe aleatëve për të dislokuar shpejt trupa dhe pajisje luftarake në Evropë.

Kjo stërvitje theksoi përkushtimin e Shqipërisë si një aleate e besueshme e NATO-s dhe kontribui në rritjen e respektit ndërkombëtar të vendit.

DEFENDER 24’ dhe pjesëmarrja e Shqipërisë

Në vitin 2024, Shqipëria mori pjesë në

stërvitjen më të madhe të NATO-s që nga Lufta e Ftohtë, STEADFAST DEFENDER ’24, e cila përfshiu mbi 90,000 trupa nga të gjitha 32 vendet anëtare të NATO-s. Kjo stërvitje synonte të testonte aftësinë e aleancës për të reaguar shpejt ndaj kërcënimeve në krahun lindor dhe për të forcuar strategjinë e saj të parandalimit dhe mbrojtjes.

Shqipëria kontribuoi në këtë stërvitje përmes pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura në manovra të ndryshme, duke përfshirë trajnime të përbashkëta me aleatët në fushat e logjistikës, mbrojtjes kibernetike dhe operacioneve speciale. Kjo pjesëmarrje forcoi më tej integrimin e Shqipërisë në strukturat e NATO-s dhe rriti kapacitetet e saj ushtarake.

Përfitimet e Shqipërisë

Rritja e kapaciteteve ushtarake: Stërvitjet ndihmojnë në përmirësimin e aftësive operationale të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe në përvetësimin e standardeve të NATO-s. Forcimi i partneriteteve ndërkombëtare: Pjesëmarrja në këto stërvitje thellon bashkëpunimin me SHBA-në dhe vendet e tjera aleate, duke e pozicionuar Shqipërinë si një partner të rëndësishëm në sigurinë rajonale. **Rritja e profilit ndërkombëtar:** Organizimi dhe pjesëmarrja aktive në stërvitje të tilla rrit reputacionin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke treguar përkushtimin e saj ndaj paqes dhe sigurisë globale. DEFENDER ’25, është e rëndësishme për Shqipërinë, sepse kontribuon në forcimin e kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe në rritjen e rolit të saj si një aleate e besueshme dhe aktive në kuadër të NATO-s.



Përfundon me sukses stërvitja “Çakalla 05-2025”

Kursi i 83-të fillestar i nënoficerit përmbylli me sukses stërvitjen komplekse 24-orëshe të koduar “Çakalla 05-2025”. Pas 5 javësh trajnim intensiv në përgatitje Fizike, Leadership, Zjarr dhe Shërbim Luftarake të Trupave, kursantët treguan aftësitë e tyre si drejtues grupi në kushtet e një skenari të vështirë taktik.

Kjo stërvitje finalizoi gjithë njohuritë e përfituara dhe u ndoq nga afër nga Zv/Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerit dhe instruktorët e Akademisë.



Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar nënshkruajnë marrëveshje në fushën e mbrojtjes, investimeve dhe marrëdhënieve industriale

Vizita e parë e një kryeministri britanik në Shqipëri solli edhe nënshkrimin e një marrëveshjeje të rëndësishme për mbrojtjen. Në prani të kryeministrit Edi Rama dhe homologut të tij Sir Keir Starmer, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe ambasadori britanik Nicholas Abbott, nënshkruan marrëveshjen për forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

Por çfarë përmban “Deklarata e qëllimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”, në lidhje me eksportet në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimin industrial?

Kjo deklaratë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt thellimit të marrëdhënieve strategjike ndërmjet dy vendeve dhe synon forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.

Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar, përmes kësaj marrëveshjeje shprehin vullnetin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin në fushën e prodhimit të pajisjeve të mbrojtjes, investimeve dhe marrëdhënieve industriale, me synim rritjen e sigurisë kombëtare dhe nxitjen e inovacionit teknologjik, duke zhvilluar partneritete me prodhues britanikë për prodhimin e mjeteve ushtarake dhe kapaciteteve të tjera, përfshirë mbrojtjen ajrore tokësore dhe sistemet kundër dronëve.

Po ashtu, përmes kësaj marrëveshjeje,



palët shprehin interesin për të eksploruar mundësitë për eksporte të përbashkëta të pajisjeve të mbrojtjes drejt vendeve të treta, me interes strategjik dhe krijuar baza për trajnime të përbashkëta dhe bashkëpunim ndërmjet forcave të armatosura të të dy vendeve.

Kjo marrëveshje nuk përbën një angazhim financiar apo ligjërishit detyrues për asnjërën palë, por vendos themelet për bashkëpunime të mëtejshme përmes marrëveshjeve të posaçme, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe angazhimet ndërkombëtare.

Ky zhvillim konfirmon angazhimin e Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar për një partneritet të fortë në fushën e Mbrojtjes, për stabilitet rajonal dhe siguri ndërkombëtare. Kryeministri i Britanisë së Madhe, sir Keir Starmer, e komentoi marrëveshjen gjatë një vizite në Qendrën e Inovacionit dhe Muzeut të Forcave të Armatosura. Ai u shpreh i kënaqur për arritjen e saj, ndërsa shtoi se për Europën po vjen një epokë e re sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes.

“Jam vërtet i kënaqur që në kontekstin më të gjerë sot, kemi arritur një marrëveshje për të përmirësuar punën që bëjmë si dy vende për sigurinë dhe mbrojtjen, duke përfshirë prodhimin dhe prokurimin, sepse mendoj se kjo është një epokë e re për Europën. Kjo është një epokë e re për sigurinë dhe mbrojtjen, ku ne lidhemi me aleatët tanë edhe më fort”, - u shpreh Starmer.

SHSHPPFA, gjeneralletenant Arben Kingji: Nga Tradita në Vizion - 67 Vite Akademi e Mbrojtjes në Themel të Ushtrisë Moderne Shqiptare

Me rastin e 67-vjetorit të themelimit të Akademisë së Mbrojtjes, sot Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, përcjell urimet më të përzemërta për drejtuesit, pedagogët, instruktorët, dhe stafin civil që kanë kontribuar dhe vijojnë kontributin në këtë vatër të dijes dhe lidershit ushtarak. Që prej 10 majit 1958, Akademia ka qenë zemra strategjike e ushtrisë sonë, një institucion që ka formuar mijëra oficerë të përkushtuar, të cilët kanë mishëruar vlerat ndaj Atdheut dhe kanë ndërtuar themelet e një ushtrie moderne, ndërvepruese me NATO-n dhe të denjë për një vend kandidat për Bashkimin Evropian.

Sot, përballë sfidave të një bote që ndryshon me ritme të shpejta, arsimi ushtarak nuk është më vetëm një proces akademik, por një instrument thelbësor i sigurisë kombëtare.

Në këtë kuadër, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë po përqafohet me të ardhmen, me transformime strukturore, infrastrukture bashkëkohore, kurrikula cilësore dhe të modernizuara, teknologji të avancuar, akreditim kombëtar, ndërkombëtar dhe një horizont të qartë për shtrirje më të avancuar kombëtarë dhe rajonale të studimeve për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Programet e arsimit ushtarak janë gjithnjë e më shumë në vartësi të nevojave të sotme dhe të nesërme operationale të Forcave të Armatosura, të institucioneve të sigurisë në vend, duke synuar edukimin e një trupe oficerësh dhe civilësh të përgatitur profesionalisht dhe të pajisur me aftësi për të udhëhequr në një mjedis gjithnjë e më kompleks e të paparashikueshëm. Për më tepër, bashkëpunimi me institucione të ekselencës ushtarake rajonale dhe të NATO-s është dëshmi e promovimit rajonal në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe e angazhimit për përsosmëri në formimin e liderëve me integritet, vizion dhe përgjegjësi kombëtare, bashkëpunim që duhet thelluar e konsoliduar më tej, etj.

Në këtë përvjetor, shpreh falënderimin tim më të thellë të gjithë brezave që kanë kontribuar ndër vite në këtë institucion elitar të Forcave të Armatosura.

I inkurajoj brezat e rinj të oficerëve që programet arsimore e stërvitore t'i perceptojnë jo thjesht si promovim në karrierë apo detyrë, por si një mision në shërbim të Forcave të Armatosura, Atdheut dhe vlerave euroatlantike, me dije, përkushtim dhe vizion.

Urime përvjetorin!



Gjeneralmajor Ferdinand Dimo mori pjesë në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, mori pjesë në takimin dyditor të komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, zhvilluar në Qendrën e Planifikimit të Operacioneve Ajrore në Lion, Francë.

Qëllimi i këtij takimi ishte ndarja e mendimeve dhe reflektime mbi kuptimin e garancive të sigurisë për Ukrainën, për sa i përket fushës ajrore dhe njohja me planet reale dhe ato mbështetëse të forcave të koalicionit në rast situatë luftarake.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

67 vite KMS, histori, krenari dhe përkushtim në shërbim të sigurisë kombëtare

Me rastin e 67-vjetorit të krijimit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, një prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit ushtarak në vend, kemi kënaqësinë të sjellim një intervistë ekskluzive me Komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili ndan me ne vizionin, sfidat dhe sukseset e Kolegjit ndër vite.

Z. Gjeneral, si do ta përshkruanit rrugëtimin 67-vjeçar të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë? Cilat janë momentet më kulmore të këtij institucioni?

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) aktualisht është njësi në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në historinë e arsimit ushtarak shqiptar 10 maji është një nga ditët më të rëndësishme, pasi data 10 maj 1958 është dita e themelimit të Akademisë së Mbrojtjes, sot KMS.

Krijimi i KMS qysh në krye të herës dhe struktura aktuale, ka ardhur si domosdoshmëri e ndarjes së arsimit për zhvillimin e karrierës së personelit ushtarak dhe civil dhe si nevojë e përmirësimit të vazhdueshëm cilësor në përshtatje me zhvillimet më të fundit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ky Kolegj vjen nga përvoja e arsimit tonë ushtarak të pasur ndër vite, si dhe pas anëtarësimit në NATO nga eksperiencia e vendeve Baltike dhe e shumë vendeve të NATO-s, tashmë si strukturë më vete arsimore brenda Forcave tona të Armatosura, për të cilën si momentin më kulmor do të përshkruaja pikërisht anëtarësimi në NATO dhe aplikimi i programeve studimore sipas standardeve të Aleancës.

Në Forcat e Armatosura kjo strukturë tashmë është institucioni i Arsimit të Lartë Ushtarak Profesional për të gjitha kurset e karrierës të FARSH deri në nivelin strategjik, nëpërmjet aplikimit të metodave dhe parimeve më të përparuara dhe më të përditësuara arsimore, menaxhimit efektiv dhe përdorimit të burimeve intelektuale shkencore dhe materiale.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha me të cilat është përballur Kolegji ndër vite dhe si janë tejkaluar ato?

Misioni i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë është edukimi dhe kualifikimi i personelit ushtarak e civil nëpërmjet programit mësimor, në nivelet e larta të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare, për përdorimin kreativ dhe me efikasitet të elementëve të fuqisë kombëtare në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe arsimimin e liderëve civilë e ushtarakë të vendeve partnere dhe të NATO-s.

Duke parë misionin e institucionit tonë, do të thosha që sfida e vazhdueshme për ne ka qenë dhe vijon të jetë edukimi dhe kualifikimi i të gjithë personelit të FARSH në përputhje dhe përshtatje të programeve dhe kurrikulave bashkëkohore të Aleancës dhe vendeve partnere (të BE, FSK, etj.)

Si është transformuar roli i Kolegjit në raport me zhvillimet moderne të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare?

Siç e citova dhe më sipër, KMS ka ndryshuar ndër vite, duke u përshtatur me sfidat e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit dhe duke patur qasje sipas standardeve të vendeve të Aleancës dhe atyre partnere.



Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj



MISIONI I KOLEGJIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË ËSHTË EDUKIMI DHE KUALIFIKIMI I PERSONELIT USHTARAK E CIVIL NËPËRMJET PROGRAMIT MËSIMOR, NË NIVELET E LARTA TË DREJTIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË SIGURISË KOMBËTARE, PËR PËRDORIMIN KREATIV DHE ME EFIKASITET TË ELEMENTËVE TË FUQISË KOMBËTARE NË KOHË PAQE, KRIZE DHE LUFTE, SI DHE ARSIMIMIN E LIDERËVE CIVILË E USHTARAKË TË VENDEVE PARTNERE DHE TË NATO-S.

Në këtë institucion planifikohen, zhvillohen dhe drejtohen kurset e karrierës të Oficerit KTHOSH, KKSHP, KLO dhe KLMS. Ndërkohë, aktualisht jemi në një fazë tjetër ristrukturimi, ku krahas edukimit dhe formimit të Oficerëve, në këtë Kolegj do të jenë në vartësi edhe Qendra e Arsimitit Profesional të N/Oficerit (KBNO, KANO, KLNO, KKrKapterit) dhe Qendra e Arsimitit të Ushtarit Profesionalist (SIB, SIA) dhe në këtë mënyrë, siç e shikoni kjo strukturë e re do të kryejë edukimin dhe formimin

profesional ushtarak të të gjithë efektivëve të FARSH.

Gjithashtu, në kuadrin e qasjes rajonale KMS kemi ambicien që në një të ardhme të afërt në bashkëpunim me Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të kalojë nën frymën e ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku kursantët e KKSHP dhe KLO, përveç diplomës ose certifikatës për kurset institucionale të mund të marrin dhe diplomën “Master Profesional”, “Master Shkencor” në



“NË KËTË VIT AKADEMIK, NË KOLEGJ ËSHTË ZHVILLUAR EDHE NJË VIZITË E KOLEGJIT TË MBROJTJES SË NATO-S ME SELI NË ROMË TË ITALISË, SI DHE VIZITA E KRYETARIT TE KOMITETIT USHTARAK TE NATO-S, I CILI MBAJTI NJË LEKSION TË SHKURTËR PËR KURSET E KOLEGJIT.

fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, (ku pas arritjes së kësaj ambicie, do të shikohet mundësia e marrjes së masterit edhe nga personeli N/Oficer).

**Edukimi ushtarak është themeli i një shteti të sigurt
Çfarë vendi zë Kolegji në edukimin dhe formimin profesional të oficerëve të Forcave të Armatosura dhe institucioneve të tjera të sigurisë?**

Në kuadër të ristrukturimit të Forcave të Armatosura dhe si rrjedhojë edhe të Kolegjit, ashtu siç e përmenda më parë, ky institucion kryen edukimin dhe formimin profesional të të gjithë personelit të FARSH, duke filluar nga trajnimi dhe certifikimi i rekrutëve, formimi, arsimimi dhe kualifikimi i N/oficerëve dhe civilë (C2) të administratës së FA-së (në nivel administrativ), si dhe të oficerëve pas titullimit të tyre nga niveli i oficerit të Shtabit (major) (pa harruar edhe oponencën dhe certifikimin që iu bëhet shkollave të trupës apo QS të Komandave të Forcave Tok, Aj. Det.) deri në nivel strategjik (Gjeneral) me kursin e KLSM (Kurs i certifikuar nga NATO), duke e bërë kështu institucion shumë të rëndësishëm dhe të vetmin në rang FA për formimin ushtarak e të gjithë hallkave të zinxhirit hierarkik të FARSH.

A mund të ndani me ne disa nga risitë që janë aplikuar në programet mësimore apo në qasjen strategjike të Kolegjit në vitet e fundit?

Ndër vite, qysh në krye të herës që me aplikimin për të qenë anëtar i NATO-s dhe deri kur Shqipëria u bë pjesë e Aleancës, në KMS është punuar sistematikisht dhe në vijimësi për përditësimin e programeve mësimore në çdo fushë dhe për çdo hallkë të zinxhirit hierarkik të personelit të FARSH.

Në çdo përfundim viti akademik apo kursi të rekrutëve (SIB dhe SIA), bazuar në politikat e arsimit dhe trajnimit

në FA, si dhe STANAG-ve (dok. standard të vendeve të NATO-s) të ratifikuar, programet e arsimim-trajnitimit janë një proces rishikimi i vazhdueshëm, kjo në bazë nevojave dhe përshtatjes së sfidave që vijnë në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të cilën aktualisht rendi botëror nuk është më ai i viteve 90-2000.

Këto ndryshime kryhen në bazë të mësimëve të nxjerra, udhëzimeve që vijnë nga instancat eprorë dhe pasi punohen me grupe pune sipas instancave, miratohen nga dega e Kurrikulës së KMS. Këtu do të shtoja që pasqyrohen edhe sugjerime/rekomandime nga vendet tona aleate dhe partnere (NATO, Garda Kombëtare e New Jersey-it dhe FSK për N/Of dhe UA, etj.).

Ndërkohë, risi tjetër mund të shtoja që në kurset e larta të oficerëve, në mënyrë që të njihen sa më mirë me institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare, vitet e fundit janë aplikuar vizita të ndryshme në Parlament, Presidencë, JFC Napoli, NATO LCC, institucionet e NATO-s në Bruksel, Romë, Kosovë, etj.

Në këtë vit akademik, në Kolegji është zhvilluar edhe një vizitë e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s me seli në Romë të Italisë, si dhe vizita e Kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, i cili mbajti një leksion të shkurtër për kurset e Kolegjit.

**“Bashkëpunimi ndërkombëtar është çelësi i suksesit”
Si e shihni bashkëpunimin ndërkombëtar të Kolegjit?
Cilat janë vendet apo institucionet me të cilat keni ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi?**

KMS ka bashkëpunuar dhe do të vijojë të bashkëpunojë me vendet e Aleancës dhe partnere për çdo hallkë të zinxhirit hierarkik.

Më konkretisht për personelin oficer, në kuadër të kurseve të larta dhe kryesisht për KLSM (si një kurs

rajonat i certifikuar nga NATO), prej kohësh janë ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me strukturat e arsimit ushtarak të NATO-s dhe ato civile si: Qendra “Marshall” Gjermani, Kolegji i Baltikut, Universitetit për bashkëpunimin për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Uashington DC USA, Instituti për Studime Globale në Romë Itali, Drejtorinë për bashkëpunim ndërkombëtar për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme Italiane, Universiteti “Bajazit” në Turqi, NATO HQ Sarajevo B&H, Universiteti i Administrimit Publik në Këln Gjermani, USA CIS, Ministria e Mbrojtjes së Kosovës. Gjithashtu, e veçanta e KLSM-së për këtë vit, ishte se kishim lektorë edhe nga STRATCOM COE, Letoni dhe EU MC Bruksel. Ndërkohë kemi patur gjithmonë si guest speaker Ambasadorë dhe Diplomata të akredituar në vendin tonë, veçanërisht nga vendet që kanë përfaqësues në KLSM

Për sa i përket edukimit, trajnimit dhe formimit profesional të trupës së N/Oficerëve dhe Ushtarëve Profesionist, ka patur një bashkëpunim të qëndrueshëm me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit dhe KDS të FSK.

Ndërkohë që në kuadër të aspirimit të anëtarësimit në BE, jo më larg se muaji prill i këtij viti, ka filluar puna për shikimin e mundësive për anëtarësim dhe bashkëpunim me Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë së BE-së (duke zhvilluar 1 ose më shumë kurse ose modul të 1 kursi).

**“67 vite krenari – një histori që vazhdon”
Në këtë përvjetor të 67-të, cili është mesazhi juaj për të gjithë personelin, studentët dhe aleatët e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë?**

Për personelin, mesazhi do të ishte: vijoni të azhurnoheni dhe vetë zhvilloheni, duke përdorur edhe zhvillimet teknike që intelijenca artificiale ofron.

Për studentët, mesazhi do të ishte: vijoni të ndiqni me përkushtim leksionet në KMS, por gjithashtu mos reshtni së adaptuari dhe të jeni gjithmonë kuriozë për vetëzhvillim.

Për aleatët, mesazhi do të ishte: KMS do të jetë gjithmonë 1 institucion i besueshëm dhe i hapur, duke adaptuar praktikat arsimore-trajnuese më të mira bashkëkohore.

Si e shihni të ardhmen e Kolegjit në një kontekst të ndryshimeve të vazhdueshme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes?

Kryefjala në KMS do të jetë adaptimi dhe vetëzhvillimi i personelit arsimor dhe trajnues, në mënyrë që të jenë gjithmonë koherent me zhvillimet e kohës dhe për të qenë të aftë për të transmetuar tek efektivit student-rekrut informacionin bashkëkohor.



Sot bazë e NATO-s, 70 vite nga krijimi i Regjimentit të Parë të Aviacionit Ushtarak Shqiptar në Kuçovë

Regjimenti i Aviacionit Luftarak, Kuçovë

Baza e Kuçovës është reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë. Data 15 maj e vitit 1955 është dita e krijimit të regjimentit, ligjëruar pas vendim të Kuvendit Popullor nr.81, datë 06.11.1956.

Regjimenti përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktive MIG-15, të cilët, pasi u montuan në aerodromin e Tiranës dhe u kolauduan nga dy pilotët rusë, u dislokuan në aerodromin e Kuçovës, të porsa ndërtuar nga xhenierët shqiptarë. Më 15 maj, regjimentit iu dorëzua Flamuri Luftarak “Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës PEZA”. Ky lajm i botuar në gazetën zyrtare të vitit 1956 është padyshim një nga ngjarjet me rëndësi për kohën dhe vendin e varfër të Ballkanit. Komandant u caktua Niko Hoxha, zëvendëskomandant Fahri Bubësi, zëvendëskomandant për punën politike Babaçe Faiku, kryeinxhinier Qirjako Trebicka, komandant i skuadriljes së parë Vasil Trasha, inxhinier skuadrilje Daut Gurabardhi, komandant i skuadriljes së dytë Peço Polena, inxhinier skuadrilje Hajrulla Jubani, navigator i repartit Masar Aga, ndërsa për nënrepartet e shërbimit Simon Nasko, Shef ndërlidhje Sotir Kano, komandant i shërbimit të radio-dritës Andrea Kule,

Efektivi pilot e teknik i këtij regjimenti, në pjesën më të madhe ishte përgatitur fillimisht në ish-Jugosllavi e më pas në ish-Bashkimin Sovjetik.

Prej kohësh, në Kuçovë ishin sistemuar e kishin filluar përgatitjet pilotë të shquar, si: Niko Hoxha, Edip Ohri, Babaçe Faiku, Fahri Bubësi, Vasil Trasha, Masar Aga, Elmaz Hasanmataj, Refat Kasimati, Peço Polena, Sazan Xhelo, Koço Andoni, Lulo Musaj, Goxho Kondi, Kosta Dede, Tomorr Avdia, Zebo Dyrmishi, Bajram Hita, Hektor Lako etj.

Po kështu edhe mjaft teknikë të përgatitur, si: Qirjako Trebicka, Met Farka-inxhinier i armatimit, Sokrat Manastirliu-inxhinier për pajimet speciale, Raqi Sevo, Shaqo Hoxha-inxhinier për radion, Daut Gurabardhi, Servet Tusha, Yzedin Koçi, Foto Lako, Hajrulla Jubani, Novruz



REGJIMENTI PËRBËHEJ NGA DY SKUADRILJE AVIONËSH REAKTIVE MIG-15, TË CILËT, PASI U MONTUAN NË AERODROMIN E TIRANËS DHE U KOLAUDUAN NGA DY PILOTËT RUSË, U DISLOKUAN NË AERODROMIN E KUÇOVËS, TË PORSA NDËRTUAR NGA XHENIERËT SHQIPTARË. MË 15 MAJ, REGJIMENTIT IU DORËZUA FLAMURI LUFTARAK “REGJIMENTI 23 I AVIACIONIT GJUAJTËS PEZA”.

Kacileri, Qani Veizi, Nexhip Nanushi, Jorgji Bitri, Hamdi Mullaj, Petrika Manastirliu, Kristo Pulla, Nevruz Selami, Stavri Gerdupi, Teki Goxhaj etj.

Në janar të vitit 1956 në regjiment filloi viti i rregullt i përgatitjes luftarake. Në këtë vit një pjesë e pilotëve u nisën për studime për helikopterë në ish-Bashkimin Sovjetik.

Në korrik të vitit 1957 për herë të parë u ul avioni bombardues Il-28, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Vetëm dy vjet pas krijimit të regjimentit, në Kuçovë filloi përgatitja e pilotëve për Klasin e Parë. Në nëntor të atij viti u titulluan pilotë të Klasit të Parë Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubësi, Babaçe Faiku, Vasil Trasha, Haki Jupasi, Thanasi Gjoknuri. E gjithë kjo përgatitje e lartë e pilotëve duket se pati rast ‘të testohet’ në dhjetorin e po atij viti, pasi çifti i avionëve roje, pas dhënies së sinjalit për

shkeljen e hapësirës ajrore, u ngrit në ajër dhe detyroi të ulet në aerodrom një avion transporti anglez “Skaimaster”.

Presidiumi i Kuvendit Popullor, me vendim Nr.2651 dt. 26.04.1958, për kryerjen me sukses të kësaj detyre, i dekoroi pilotët Kosta Dede e Mahmut Hysa, si dhe avion-drejtuesin Shyqyri Balla.

Në muajin prill të vitit 1959 filloi puna për remontin e mesëm të avionit MIG-15 me efektivat e repartit. Ish-Bashkimi Sovjetik ishte tepër larg për të kërkuar që një gjë e tillë të realizohej në vendin që prodhonte avionët.

U krijua një grup remonti pranë oficinës së mirëmbajtjes së avionëve, i përbërë nga inxhinierët Stefan Kagjini, Nexhip Manushin dhe Nasi Themelin, ndërsa nga inxhinierët e naftës u caktuan Petrika Ballauri, Koço Pepa dhe Lllazar Kreshpani.

Në vitin 1960 u hodh ideja e prodhimit të vajgurit në vendin tonë, dhe për këtë u kërkua një bashkëpunim i ngushtë me inxhinierët e naftës. Nga reparti i Kuçovës me këtë detyrë u ngarkua një grup pune me në krye inxhinierin Stefan Kagjinin dhe me Nexhip Manushin e Nasi Themelin, ndërsa nga inxhinierët e naftës u caktuan Petrika Ballauri, Koço Pepa e Llazar Kreshpani. Në muajin prill të vitit 1961, u bë për herë të parë eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare, prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës, ndërsa komandanti Niko Hoxha bëri me sukses provën në ajër me avionin 332.

Më 12 prill të vitit 1968, piloti Qirjako Dhima kreu me sukses kontrollin teknik të avionit MIG-15, pas kryerjes për herë të parë të riparimit kapital nga Uzina e Aviacionit. Më 13 maj 1983 u bë kontrolli në ajër i motorit të avionit MIG-19, pas riparimit kapital të tij në uzinë nga piloti Harilla Rebi, eksperiment ku mori pjesë zëvendëskryeministri Simon Stefani.

Dy vjet më vonë, në maj të viti 1985, pilotët Epaminonda Tupa dhe Koço Biku kryen provën e motorit të parë të avionit MIG-15, pas riparimit të këtij të fundit në vend.

Në vitin 1980, nga efektiv i inxhinero-teknik i këtij reparti ishte prodhuar banko-prova për kontrollin e topave 30 mm, si dhe pajisja për kontrollin e frenimit automatik të rrotave.

Në vitin 1974 ky regjiment mori pjesë në paradën ushtarake me 27 avionë në fluturim, tri treshe avionësh MIG-19, tri treshe avionësh MIG-17 dhe tri treshe avionësh MIG-15. I veçantë është edhe roli kinematografik i këtij reparti.

Në mars të vitit 1981 ai dha një ndihmë të çmuar në realizimin e filmit artistik me titull ‘Gjurmë në kaltërsi të Kinostudios “Shqipëria e Re” kushtuar armës së aviacionit. Pilotët Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili, Gjergji Spaho etj., ishin, protagonistë të filmit, por edhe kryen një sasi të madhe fluturimesh në funksion të filmit.

23 dhjetor. Një avion luftarak amerikan i tipit T-33 shkeli hapësirën ajrore shqiptare. Dy avionë të tipit MiG-15 u ngritën nga baza ajrore e Kuçovës, të pilotuar nga Anastas Ngjela dhe Mahmut Hysa. Avioni ulet në pistën e pambaruar të Rinasit. Avioni u sekuestrua, ndërsa piloti amerikan u lirua më 11 janar 1958. Pas disa vitesh të qëndrimit të tij në rrethinat e repartit të Rinasit, maketi i këtij avioni u vendos në muzeun e armëve në kështjellën e Gjirokastrës.

Më 31 dhjetor 1958, një avion tjetër i huaj u kap nga avionët reaktivë të bazës së Kuçovës. Ky ishte një C-54D “Skymaster”. Avioni u detyrua të ulej në bazën e Kuçovës, dhe më pas pilotët dhe avioni u liruan.

Shtator 1959. Regjimenti merr pjesë në stërvitjen me trupat e armatës në rajonin e Ersekës. Në këtë

stërvitje u bë imitimi i hedhjes së bombës atomike nga zëvendëskomandanti i regjimentit Fahri Bubësi, Po gjatë këtij viti, u krye përvetësimi i uljes dhe ngritjes në dy aerodrome fushore, në atë të Shkodrës dhe të Pish-Poros. I pari u ul piloti Niko Hoxha dhe pas tij Fahri Bubësi, Koço Andoni, Tomor Avdia, Goxho Kondi, Sali Dibra, Sokrat Prifti.

Qershor 1961. Reparti ribazohet në aerodromin e Pish-Poros ku filluan fluturimet intensive ditën dhe natën. Ky ishte ribazimi i parë për të gjithë regjimentin në një aerodrom fushor.

Mars 1965. U krijua skuadrilja e tretë reaktive-mësimore, për përgatitjen e pilotëve e teknikëve të rinj, me komandant Sali Dibra.

Prill 1966 Reparti u pajis me një skuadrilje MIG -17. Korrik 1967. U bë eksperimentimi i uljes dhe ngjitjes në aerodromin e Cërrikut me dy avionë MIG-15, me pilotët Viktor Vangjeli e Qirjako Dhima dhe një avion MIG-17 me pilot Azbi Seranin.

U eksperimentua ulja e dy çifteve me avionë MIG-17 aerodromin e Korçës, nga pilotët Azbi Serani, Qirjako Dhima, Hamza Koçi e Harilla Rebi.

Qershor 1970. Në Kuçovë fillojnë fluturimet avionët MIG-19. Më 3 nëntor për herë të parë filloi të kryhet shërbimi me avionët MIG-19

Shtator 1976. Zhvillohen qitje me raketa e topa natën. Në tetor, largohet nga reparti skuadrilja e avionëve MIG-19 me komandant skuadrilje Et’hem Aliaj dhe Hamza Koçi, që i kalojnë Regjimentit të ri në Gjadër.

Dhjetor 1983. U eksperimentua ngritja nga pista

urgjente nga pilotet Harilla Rebi e Gjergj Spaho.

Komandantë të Regjimentit të Kuçovës Kolonel Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Refat Kasimati, Bardhyl Taçi, Harilla Rebi, Vasil Andoni, kolonel Agim Balili, kolonel Fatmir Meçe, kolonel Agim Matraku, kolonel Gëzim Ismaili, kolonel Epaminonda Tupa, nënkolonel Andon Todri, nënkolonel Flamur Hoxha, nënkolonel Tomorr Dyrma, kolonel Syrja Gjoka.

Kolonel Niko Hoxha u caktua komandant i regjimentit të aviacionit në Kuçovë, më 15 maj 1955.

Komandant Niko Hoxha ra në krye të detyrës, më 21 nëntor 1965, ndërkohë që kryente detyrën e komandantit të Regjimentit të Rinasit.

Sot, pas 70 vitesh, Regjimenti i Kuçovës është në një dimension të ri “Baza Ajrore Taktike e NATO-s” me infrastrukturë moderne për flotën shqiptare të helikopterëve e dronëve të armatosur dhe avionët luftarakë të Aleancës, e cila do të shërbejë edhe për të çuar në një tjetër nivel përgatitjen e aviatorëve shqiptarë, ndërkohë që i jep Shqipërisë një rëndësi të re gjeostrategjike.

Si baza më e madhe e NATO-s në rajon, kjo infrastrukturë e rëndësishme, jo vetëm që rrit profilin e Shqipërisë në skenën ndërkombëtare, por gjithashtu forcon angazhimin e vendit për paqe dhe siguri në rajon, duke u kthyer në një aset të vyer të Aleancës. Riaktivizimi i këtij aeroporti ushtarak është njëkohësisht edhe pjesë e ripërtëritjes dhe rritjes së mëtejshme cilësore të flotës sonë ajrore. Dy helikopterët e rinj “Black Hawk” si dhe dronët “Bayraktar” janë pjesë e një rritjeje që do të vazhdojë.

“ 23 DHJETOR. NJË AVION LUFTARAK AMERIKAN I TIPIT T-33 SHKELI HAPËSIRËN AJRORE SHQIPTARE. DY AVIONË TË TIPIT MIG-15 U NGRITËN NGA BAZA AJRORE E KUÇOVËS, TË PILOTUAR NGA ANASTAS NGJELA DHE MAHMUT HYSA. AVIONI ULET NË PISTËN E PAMBARUAR TË RINASIT. AVIONI U SEKUESTRUAR, NDËRSA PILOTI AMERIKAN U LIRUA MË 11 JANAR 1958. PAS DISA VITESH TË QËNDRIMIT TË TIJ NË RRETHINAT E REPARTIT TË RINASIT, MAKETI I KËTIJ AVIONI U VENDOS NË MUZEUN E ARMËVE NË KËSHTJELLËN E GJIROKASTRËS.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një qytet ku dielli ngrihet i lodhur mbi ndërtesat, jetonte Kasandra – jo një emër, por një shenjë. Ishte e bukur, por jo në mënyrën që të pushton zemrën, ajo të ngërthente shpirtin. Flokët e saj si nata, të gjatë sa një premtim i pa mbajtur, lëviznin nëpër rrugët e errëta si mjegulla që sjell harresë. Askush nuk e pa ndonjëherë të qeshte singërisht.

Ajo ofronte çfarë nuk të duhej, por të bënte ta dëshiroje. Dhe kështu, djemtë e vajzat, me ëndrrat ende të paprera, e ndiqnin. Në fillim për kuriozitet. Pastaj për rehati. Dhe më në fund... nga frika e kthimit mbrapsht.

‘Kasandra’ nuk kishte moshë por histori. Ishte aty kur për herë të parë një nxënës e shikoi jetën me sy të turbullt. Ishte aty kur një vajzë la shkollën për një premtim bosh. Ishte aty kur një nënë qau për djalë që nuk u kthye. Por askush nuk e shikonte atë si shkakun – vetëm si hijen. Thonë se ajo nuk flet, vetëm të josh. Nuk të detyron, por të mashtron. Dhe kur e kupton, je bërë pjesë e saj. Në çdo qytet shqiptar, në çdo rrugicë të mbytur nga zërat që heshtin, ajo endet. Njerëzit e njohin me emra të ndryshëm: “substancia”, “arratisje”, “shokë të këqij”, “kënaqësi e shpejtë”. Por ne e quajmë me emrin e saj të vërtetë: ‘Kasandra’.

Ajo nuk është thjesht një personazh, ajo është realiteti që vret heshtur. Dhe vetëm duke e emërtuar, mund ta luftojmë.

Në një Shqipëri që ecën me hapa të shpejtë drejt modernitetit, ku teknologjia dhe informacioni depërtojnë deri në skutat më të thella të shoqërisë, kemi harruar të ndalemi dhe të pyesim: Si po jetojnë të rinjtë tanë? Çfarë i mundon? Ku po kërkojnë qetësi?

Për shumë prej tyre, përgjigjja është e frikshme: në substancia që premtuan liri dhe sollën robëri. Në fillim si kuriozitet, më pas si strehë e përkohshme nga ankthi, stresi, mungesa e përkrahjes emocionale, e më në fund si burg shpirtëror nga i cili është vështirë të dalësh pa ndihmë.

Nga argëtimi tek varësia, rrëshqitja që askush nuk e sheh

Në auditorët e shkollave, në tavolinat e kafeneve, në rrjetet sociale ku gjithçka duket “cool”, drogat janë bërë një pjesë thujse e padukshme, por shumë prezente.

Emra të rinj, forma të reja, mënyra të reja përdorimi, por gjithmonë me të njëjtin përfundim: shkatërrim të ngadaltë, të heshtur, të përbrendshëm. Të rinjtë nuk e zgjedhin gjithmonë me vetëdije këtë rrugë. Shpesh është mungesa e dialogut, presioni social, mungesa e kuptimit të brendshëm, që i shtyn drejt një zgjidhjeje që duket më e lehtë: një pilulë për të harruar, një cigare për të “qetësuar veten”, një substancë që “të bën më i fortë në grup”.

Por varësia nuk pyet për moshë, nuk ndalet te një herë. Ajo ndërton zinxhirë emocionalë që lidhen me mendjen, trupin, dhe jetën. E ndërsa ne flasim për “raste të veçuara”, realiteti është ndryshe: gjithnjë e më shumë të rinj bien pre e kësaj “Kasandre moderne”.

Kujemi ne të rriturit?

Përballë kësaj krize të heshtur, mësuesit, psikologët, prindërit dhe institucionet kanë shpesh rolin e fundit, kur gjithçka ka ndodhur tashmë. Ne flasim për ndëshkime, për dënime, për rregulla – por harrojmë se parandalimi është mjeti më i fuqishëm.

Të rinjtë kanë nevojë për më shumë se orë mësimi. Kanë nevojë për dëgjim të vërtetë, për edukim emocional, për përfshirje në vendimmarrje, për hapësirë ku mund të jenë vetvetja pa u gjykuar. Në mungesë të këtyre, ata kërkojnë qetësi atje ku s’ka jetë, te droga.

Duhet të flasim. Të thyejmë heshtjen. Të përfshijmë të gjithë: nxënës, mësues, prindër, profesionistë të shëndetit mendor.

Duhet të ndërtojmë fushata të drejtpërdrejta në shkolla. Jo thjesht për të thënë “droga është e keqe”, por për të treguar pse të rinjtë e zgjedhin atë dhe si të gjejmë zgjidhje më të shëndetshme.

Duhet të krijojmë rrjete mbështetjeje, ku një i ri mund të thotë “Kam nevojë për ndihmë”, pa u turpëruar.

“KASANDRA”

Vajza që Puthi Terrin



NË NJË SHQIPËRI QË ECËN ME HAPA TË SHPEJTË DREJT MODERNITETIT, KU TEKNOLOGJIA DHE INFORMACIONI DEPËRTOJNË DERI NË SKUTAT MË TË THELLA TË SHOQËRISË, KEMI HARRUAR TË NDALEMI DHE TË PYESIM: SI PO JETOJNË TË RINJTË TANË? ÇFARË I MUNDON? KU PO KËRKOJNË QETËSI?

Duhet të krijojmë hapësira dialogu, ku prindi nuk mban fjalimin klasik, por dëgjon dhe kupton. Ku psikologu nuk shihet si “ai që punon vetëm me të sëmurë”, por si mbështetës për çdo sfidë.

Mos i kthejmë shpinën realitetit

Nëse ne, si shoqëri, mbyllim sytë, atëherë Kasandra do të vazhdojë të shëtisë nëpër qytetet tona, të pushtojë mendjet dhe trupat e brezit të ri. Ajo nuk ka nevojë të trokasë, sepse ne shpesh ia lemë derën hapur.

Por nëse flasim, nëse mësojmë, nëse veprojmë me dashuri dhe përgjegjësi, atëherë ajo humbet fuqinë.

Është koha të zgjohemi. Është koha të shohim përtej sipërfaqes. Është koha të mbrojmë ata që nesër do të jenë mësuesit, udhëheqësit dhe prindërit e brezit të ardhshëm. Në shoqërinë moderne, një nga sfidat më të mëdha që përballemi është përhapja e drogës dhe pasojat e saj të shumta. Droga nuk është vetëm një problem individual, por një plagë sociale që prek familjet, shkollat, institucionet dhe të ardhmen e një kombi. Të kthesh shpinën ndaj këtij realiteti do të thotë të injorosh rënkimin e një shoqërie që po përpiket të mbijetojë në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar.

Përdorimi i drogës prek më shumë të rinjtë, të cilët shpesh bien pre e ndikimeve negative, mungesës së orientimit dhe presionit të shoqërisë. Në mungesë të mbështetjes familjare ose edukimit të duhur, shumë prej tyre gjejnë në drogë një “zgjidhje të përkohshme” për problemet që përballen. Por

kjo zgjidhje shpejt kthehet në një varësi shkatërruese, duke i larguar nga arsimi, puna dhe jeta e shëndetshme.

Droga nuk prek vetëm individin që e konsumon. Ajo prek të gjithë rrethin përreth tij. Familjet përballen me vuajtje emocionale, shqetësime financiare dhe ndjenjën e pafuqisë.

Shoqëria humbet potencialin e qytetarëve të saj të rinj, të cilët në vend që të kontribuojnë, shpesh përfundojnë viktimat të kriminalitetit apo sistemeve shëndetësore të mbingarkuara.

Të kthesh shpinën ndaj drogës do të thotë të pranosh heshturazi shkatërrimin e brezit të ri. Por a kemi të drejtë të heshtim? A kemi të drejtë të mos reagojmë kur shohim se një mik, një familjar, një nxënës po humb rrugën për shkak të këtij fenomeni?

Zgjidhja nuk është e thjeshtë, por e domosdoshme. Edukimi në familje dhe shkolla, krijimi i alternativave për të rinjtë, ndihma psikologjike, fuqizimi i institucioneve dhe bashkëpunimi i të gjithëve janë çelësat për të luftuar këtë problem. Nuk mund të presim që vetëm shteti të bëjë gjithçka. Lufta kundër drogës është përgjegjësi e përbashkët.

Droga është një realitet që s’mund të fshihet nën qilim. Ajo është kërcënim i heshtur, por i pranishëm. Të mos i kthejmë shpinën këtij realiteti, por të përballemi me të, është hapi i parë drejt një shoqërie më të shëndetshme dhe më të drejtë. **Sepse heshtja sot, mund të na kushtojë një brez nesër.**



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Mjeshtëri i Madh

Kujtojmë komandantin e shquar dhe mendimtarin ushtarak që la pas një trashëgimi të paçmueshme në fushën ushtarake dhe akademike, Kostaq Karoli gjeneral, prof. dr. Ai ishte një figurë që ndërthurte vlerat e drejtuesit të patundur me pasionin për mësimdhënie dhe edukimin e kuadrit të lartë të Forcave të Armatosura. Ka lindur më 14 dhjetor 1945, në Korçë, por u rrit në fisin e qytetarisë dhe të patriotizmit të Karolëve në Elbasan dhe shërbeu për shumë vite në Tiranë ku dhe ndërroi jetë, më 28 prill 2025.

Nisi mësimet ushtarake në vitet 1959-1963 në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, dhe i vijoi studimet ushtarake në vitet 1963-1965 në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”. Ndërsa në vitet 1975-1977 ndoqi studimet akademike në Akademinë e Mbrojtjes “Mehmet Shehu” dhe në vitin 1986 përfundoi kursin e Shtatmadhorisë. Ndoqi kurse të ndryshme kualifikimi ushtarak dhe dha provime për matematikë, psikologji, për problemet e stërvitjes, të historisë ushtarake etj. Pas gradave shkencore “Kandidat i shkencave”, “Docent” dhe “Doktor” fitoi titullin akademik “Profesor”, për të shërbyer gjatë gjithë karrierës së tij profesionale me një performancë të admirueshme që kompletohej pareshtur në vite.

Në karrierën e tij të gjatë si ushtarak i lartë, ai shërbeu me dinjitet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj Atdheut. E nisi karrierën ushtarake si komandant toge për të vijuar pedagog në shkollat ushtarake i profilizuar në përgatitjen dhe drejtimin e zjarrit në katedrën e zjarrit. Për këtë përgatiti dhe mbrojti drejtimin e zjarrit të nënrepartëve të këmbësorisë (mitraljere) në luftim, i cili u bë një tekst bazë në shkollat ushtarake. Më tej vijoi studimet në lëndën e gjeografisë ushtarake, ku për disa vite ka drejtuar njësi ushtarake si brigadë të këmbësorisë dhe për shumë vite komandant në Akademinë Ushtarake të FA-së.

Njëkohësisht, si profesor në fushën ushtarake, ai frymëzoi gjenerata të tëra oficerësh, studentë dhe akademistë me vizionin e tij strategjik, me ndershmërinë dhe me thellësinë e analizave të tij. Përmendim kontributet akademike, librat që ka shkruar, leksionet frymëzuese dhe pozicionet e detyrave që ka mbajtur në institucione arsimore ushtarake të vendit. Në vitin 1984 mbrojti në Akademinë e Mbrojtjes doktoratën me temë “Luftimi mësymës natën”. Më tej ai ka bërë një sërë punimesh shkencore si “Ushtrimet e qitjes me armët e këmbësorisë” tekst mësimor (1976), “Batalioni artmitralier në mbrojtje” (1997), “Bazimi teorik i kërkesës për të siguruar dendësinë e nevojshme të plumbave për metër linear para transhesë së parë të mbrojtjes” (1977), “Luftimi mësymës natën” (1979), “Drejtimi i zjarrit të nënrepartëve të këmbësorisë e mitraljere në luftim” (1984), si dhe ka qenë bashkautor i mjaft botimeve ushtarake si “Arti Ushtarak i Luftës Popullore” (1975), “Rregullorja e BrK” (1986), “Doktrina e FT” (2004) etj.

Ka realizuar studimet: “Mbi ndikimin e fortifikimit të mbrojtjes në veprimet mësymëse të forcave tona” (1988), “Mbi suprimimin e strukturës së Divizionit dhe krijimin e Brigadave në Forcat Tokësore. Dislokimi dhe problemet që dalin” (2000), “Mbi përqendrimin dhe heqjen e grup-depove të armatim-municionit në Forcat Tokësore, nevojat dhe frytshmëria ekonomike” (2003), “Mbi nevojat e vendosjes së medaljeve në FA, llojshmëria, klasifikimi dhe paraqitja e tyre” (2005), etj.

Për dhjetë vite rresht ka qenë kryetar i Këshillit Shkencor të Akademisë së Mbrojtjes, anëtar i komisionit të Lartë të Atestimit pranë Këshillit të Ministrave, anëtar i Këshillit të Botimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, anëtar i kolegjiut të Revistës “Mbrojtja”, anëtar i bordit të Revistës Ushtarake pranë Komandës së Doktrinë dhe Stërvitjes, si dhe anëtar në redaksinë e përgjithshme të Fjalorit Enciklopedik Ushtarak Shqiptar, etj.

Gjatë periudhës si kryetar i këshillit shkencor të Akademisë, ka qenë 50 herë kryetar jurie për mbrojtjen e disertacioneve, si dhe ka drejtuar punën për përgatitjen e historikëve të Brigadave Sulmuese, të Fjalorëve të Terminologjisë dhe të

Kostaq Karoli, Gjenerali me gjurmë të arta



Historisë së Artit Ushtarak të popullit shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1944.

Profesor Kostaq Karoli ka përgatitur dhe një numër metodikash të niveleve korpus, divizion, brigadë, të llojeve të ndryshme të operacioneve, luftimeve për përdorim të procesit mësimor në Akademinë e Mbrojtjes. Ai ka qenë bashkautor në mjaft dispensa, leksione mësimore dhe materiale teorike. Ai ka përgatitur dhe mbajtur konferenca brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me referate e kumtesa për probleme të sigurisë, të historisë dhe të mbrojtjes.

Të tilla kanë qenë konferenca e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve anëtare të KSBE (OSBE) në Vjenë në tetor 2001, duke referuar “Reforma në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Në revistën “NATO nations and partners for peace” në vitet 2004-2005-2006 ka botuar artikuj studimorë për ushtrinë shqiptare. Ai ka qenë në krye të punëve për përgatitjen e projekteve studimore, mikrotezave të mjaft pjesëmarrësve në programet e ndryshme që janë zhvilluar në Akademinë e Mbrojtjes.

Ka udhëhequr mbrojtjen e “doktoraturës” të tetë kandidatëve për gradën shkencore “Doktor”. Ka përgatitur me dhjetëra recensa, oponenca dhe artikuj studimorë për probleme të ushtrisë, duke i botuar në revista ushtarake, zëra për Fjalorin Enciklopedik shqiptar, si dhe filma për procesin mësimor në akademinë ushtarake, etj.

Gjeneral Kostaq Karoli, u bë një figurë e njohur dhe e nderuar në historinë moderne të ushtrisë shqiptare. Në rrugëtimin e tij, me pasionin që e kishte cilësinë kryesore, me përkushtim ai ndërtoi karrierë të gjatë në shërbim e mbrojtjes së vendit. Kudo u diplomua me rezultate të larta në institucionet ushtarake, bëri dhe ndoqi trajnime të shumta ushtarake në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. E përfaqësoi Shqipërinë denjësisht me nder në çdo

detyrë që iu besua, deri në detyrën madhore ushtarake të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, një kohë kur ndërroreshin dy sisteme. Falë horizontit të tij ushtarak, përpjekjeve të vazhdueshme në hierarkinë ushtarake, qëndroi stoik në poste të rëndësishme drejtimi, duke dhënë një kontribut të veçantë në proceset e reformimit dhe profesionalizimit të Forcave të Armatosura pas viteve ’90 të shek. XX, sidomos në hartimin e ligjeve për depolitizimin e FA, rivendosjen e gradave ushtarake, të statusit të ushtarakut, krijimin e organizimit e policisë ushtarake, rivendosjen e marrëdhënieve me ushtritë e vendeve anëtare e partnere të NATO-s, etj.

Gjenerali ishte njeri me dimensione të mëdha, mishëroi figurën e një oficerit të përkushtuar, të drejtuesit të drejtë dhe të qytetarit të ndershëm. Gjatë gjithë jetës së tij, tregoi mençuri, frymëzoi dhe kontribuoi për ushtrinë. Ai shkroi në shtypin ushtarak dhe të kohës mjaft artikuj me vlera dhe tregoi punën vetëmohuese të një ushtrie që përgatitej për mbrojtjen e Atdheut. Gjurmë kanë lënë mjaft artikuj analiza për FA si “10 korriku i zhveshur nga akuzat dhe aureolat, zona verilindore, përparësi kryesore e Shtabit të Përgjithshëm”. Forcat Tokësore të vetëdijshme për misionin e tyre, Transformimi i Forcave Tokësore, domosdoshmëri imperative, Ja përse u shkatërrua ushtria në mars ’97, Të përkushtuar për zgjerimin e kapaciteteve operacionale, “Unë, gjenerali i 17 ministrave të Mbrojtjes”, “Ushtria, si u përball me provokimet në fillim të tranzicionit”, “Ju rrëfej fuqinë e ushtrisë shqiptare”, “E vërteta e 176 mijë bunkerëve të Luftës së Ftohtë, Fortifikimi, ja pse u ndërtuan 176 mijë bunkerë”, “Konflikti i armatosur, gati 300 mijë ushtarë për 24 orë” ... libri “Kujtime” i Alfred Moisiut, sintezë e gjallë ..., “Ju rrëfej ushtrinë, si u armatosën 127 brigada e mobilizoheshin, 750 mijë” ..., “Bunkeri ishte i ushtrisë, Enveri nuk kishte zyrë”, etj.

Guximi i tij në fushën e stërvitjes dhe urtësia e tij në auditor kanë lënë një gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e të gjithë atyre që e njohën dhe mësuan prej tij. Përkushtimi i tij ndaj idealeve të lirisë, drejtësisë dhe edukimit do të mbetet një shembull i ndritshëm për brezat e ardhshëm.

Gjenerali shërbeu dhe kontribuoi me përkushtim të pasohq, me profesionalizëm të rrallë dhe integritet të palëkundur. Ai punoi e shërbeu me dinjitet për dekada në mbrojtje të atdheut dhe në forcimin e kapaciteteve ushtarake të FA-së.

Prof. Kostaq Karoli ishte një njeri me dimensione kombëtare, demonstroi kudo figurën e oficerit të përkushtuar dhe të shkencëtarit serioz, të drejtuesit të drejtë dhe të qytetarit të ndershëm dhe atdhetarit të përkushtuar. Në të gjithë karrierën e tij ushtarake, por dhe në jetë drejtoi me mençuri, frymëzoi kudo me shembullin e tij, kontribuoi pa kursim në ndërtimin e një ushtrie të kohës, të përgatitur dhe të përkushtuar për misionin kushtetues. Gjeneral Kostaq Karoli ishte i respektuar kudo në FA, por dhe në shoqërinë civile, sepse ai në jetë nuk u paraqit vetëm si një figurë ushtarake, por u paraqit si edukator dhe mësues i brezave të rinj, mik i sinqertë dhe njeri që gjithmonë vendoste atdhetarizmin mbi gjithçka tjetër.

Nga çdo vështrim politik e ushtarak, ai kishte përparësi për detyrat e rëndësishme dhe të njëpasnjëshme deri në fund të karrierës së tij. Në krah iu gjend me një përkushtim dhe përsosmëri, një nga ushtaraket e para shqiptare, Drita Prifti, e cila i qëndroi si bashkëshorte model në të gjitha detyrat e ngarkuara, si kolege dhe bashkëluftëtare e jetës.

I njohur për qetësinë në vendimmarrje, korrektësinë institucionale dhe aftësinë për të motivuar të tjerët, Gjeneral Karoli mbetet një nga figurat që lanë gjurmë të thella jo vetëm në strukturat e ushtrisë, por edhe në kujtesën e gjithë atyre që e njohën. Për të gjitha këto kontribute të dhuruara ushtrisë dhe populli të tij, ai ngelet një nga gjeneralët e rinj me personalitet dhe virtyte të larta në historinë ushtarake të Shqipërisë, të Atdheut dhe të FA-së.



“FANCY BEAR” DHE “COZY BEAR”, kërcënimi nga “ushtritë kibernetike” ruse



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Edhe për vitin 2025, Rusia, përmes GRU-së, FSB-së dhe “ushtrive kibernetike” të krijuara posaçërisht, vazhdon të përdorë strategjitë hibride për të destabilizuar Evropën dhe NATO-n. Aktivitetet e saj, që shtrihen nga spiunazhi, sabotazhi, sulmet kibernetike, deri tek dezinformimi dhe përdorimi i mercenarëve, synojnë të krijojnë kaos politik dhe ushtarak, të dobësojnë kohezionin e shteteve perëndimore dhe të sigurojnë qëllimet strategjike të Kremlinit. Brukseli, si selia e NATO-s, vazhdon të mbetet një nga pikat kryesore të shënjestrimit për GRU-në dhe FSB-në për shkak të rëndësisë strategjike që ka për operacionet dhe politikat ushtarake të Aleancës.

“Fancy Bear” dhe “Cozy Bear” janë dy nga “formacionet luftarake” më të fuqishme kibernetike dhe më të rrezikshme të lidhura dhe krijuara nga inteligjenca ruse, ku secili ka një rol të veçantë në strategjinë e luftës kibernetike të Rusisë, si pjesë e doktrinës “Gerasimov”. “Fancy Bear” është më i njohur për sulmet ndaj objekteve të sigurisë dhe informacionit të lidhur me politikat ushtarake, ndërsa “Cozy Bear” ka një fokus më të thellë në mbledhjen e informacionit diplomatik dhe të sigurisë. Këto grupe përdorin teknika të sofistikuar dhe janë të ndërlidhura ngushtë me shtetin rus, duke shërbyer si një mjet për të realizuar qëllimet e politikës së jashtme të Moskës.

Nga viti 2020, disa raporte të sigurisë kanë zbuluar se agjentët rusë kanë tentuar të spiunojnë diplomatët që mbështesin politikat e NATO-s dhe të pengojnë angazhimet e Aleancës, përfshirë përpjekjet për të arritur një marrëveshje të mundshme për mbështetje të shtuar për Ukrainën. Këto aktivitete përfshinin përdorimin e teknikave kibernetike, si phishing, për të mbledhur informacion të brendshëm mbi diskutimet dhe planet e NATO-s. Rusia ka përdorur kanale të fshehta për të ndikuar në zgjedhjet politike në shtetet anëtare të NATO-s. Disa nga këto përpjekje



“FANCY BEAR” DHE “COZY BEAR” JANË DY NGA “FORMACIONET LUFTARAKE” MË TË FUQISHME KIBERNETIKE DHE MË TË RREZIKSHME TË LIDHURA DHE KRIJUARA NGA INTELIGJENCA RUSE, KU SECILI KA NJË ROL TË VEÇANTË NË STRATEGJINË E LUFTËS KIBERNETIKE TË RUSISË, SI PJESË E DOKTRINËS “GERASIMOV”. “FANCY BEAR” ËSHTË MË I NJOHUR PËR SULMET NDAJ OBJEKTEVE TË SIGURISË DHE INFORMACIONIT TË LIDHUR ME POLITIKAT USHTARAKE, NDËRSA “COZY BEAR” KA NJË FOKUS MË TË THELLË NË MBLEDHJEN E INFORMACIONIT DIPLOMATIK DHE TË SIGURISË.

përfshijnë përdorimin e media-ve sociale dhe aktiviteteve të dezinformimit për të minuar besimin në NATO dhe për të nxitur tensione brenda shteteve të anëtarëve të Aleancës.

Napoli është një pikë kyçe strategjike, pasi është selia e Komandës së Lartë të NATO-s për Operacionet (Allied Joint Force Command Naples), që luan një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve ushtarake të Aleancës. Raportet e sigurisë të vitit 2021 zbuluan se shërbimi i inteligjencës ruse ka tentuar të infiltrojë agjentë të saj në nivelet më të larta të komandës ushtarake të NATO-s në Napoli, duke përdorur mjete të vjetra të tipit Mata Hari me spiunen (Maria Adele). Kjo është një përpjekje për të marrë informacion të klasifikuar dhe për të ndikuar në mënyrën se si NATO planifikon dhe implementon operacionet ushtarake në Evropë, si dhe për të mbledhur informacion mbi strategjitë e mbrojtjes dhe planet e mundshme të ardhshme për Ukrainën.

Në vitin 2023, agjencitë perëndimore të sigurisë raportuan për tentativa të vazhdueshme kibernetike nga GRU dhe grupe të tjera të lidhura me Rusinë për të hackuar sistemet e komunikimit dhe informacionit të Komandës së NATO-s në Napoli. Këto sulme kibernetike kanë pasur për qëllim të përftojnë të dhëna të rëndësishme ushtarake dhe të dëmtojnë sistemet që koordinonin ndihmën për Ukrainën. Nga Napoli, NATO menaxhon një pjesë të madhe të operacioneve të mbështetjes për Ukrainën, duke përfshirë

trajnime dhe dërgesa të armatimeve. Aktivitetet e spiunazhit ruse janë përqendruar në marrjen e informacionit të ndjeshëm për ndihmën ushtarake që NATO ka dërguar dhe që synon të përdoret në fushën e betejës. Këto aktivitete kanë përfshirë infiltrimin e agjentëve rusë që kërkojnë informacion mbi dërgesat e armatimeve dhe të planit të ndihmës ushtarake.

Pjesë e aktiviteteve të FSB-së dhe GRU-së ka qenë përdorimi i kanaleve të dezinformimit për të ndikuar në opinionin publik dhe për të minuar mbështetjen e opinionit publik për politikën e NATO-s. Në Itali, një nga shtetet kyçe që mbështet NATO-n dhe ka një lidhje të fortë me Aleancën, Rusia ka shpërndarë dezinformata që synojnë të përhapin pasiguri dhe të krijojnë ndasi mbi mbështetjen për dërgesat ushtarake për Ukrainën. Shërbimet e inteligjencës ruse, përmes grupeve të dezinformimit, kanë ndihmuar në përhapjen e mesazheve që kundërshtojnë përfshirjen e NATO-s në luftën e Ukrainës dhe që mbështesin partitë euroskeptike që janë më të prirura për të minuar aleancat perëndimore. Dëmtimi i marrëdhënieve të NATO-s me shtetet anëtare: Aktivitetet e GRU-së dhe FSB-së janë gjithashtu të drejtuara për të dëmtuar marrëdhëniet e NATO-s me shtetet anëtare në Evropën Jugore, si Italia dhe Spanja, për të ndihmuar në krijimin e një përçarje brenda Aleancës. Kjo mund të realizohet përmes kanaleve të influencës, si financimi i grupeve dhe lëvizjeve populiste që janë më të skeptike ndaj rolit të NATO-s.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ
SENIOR EKSPERT PËR SK, RAJONIN & NATO-n
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT

8 Maji 1945, mbetet përjetësisht i skalitur si një ngjarje madhore e fitores së njerëzimit ndaj nazifashizmit si dhe për mesazhet e “mos-harresës” që përcjell në çdo përvjetor. Fatkeqësisht, ky 80 vjetor e gjen shoqërinë njerëzore edhe me të kërcënuar, për shkak të luftës barbare që ndërmori Rusia - Putiniste, më 22 shkurt 2022, kundër jo vetëm sovranitetit të Ukrainës, por edhe ndaj rendit global, vlerave të demokracisë, interesave gjeopolitike dhe fuqisë ushtarake të Aleancës Euroatlantike.

Ky 80 vjetor e gjen Rusinë – Putiniste, edhe më të rraskapitur për të pushtuar Ukrainën jo vetëm brenda 3 muajsh (9 maj 2022), por as 3 vjet e 3 muaj. Por duke përfutur edhe nga një konfuzion ndërkombëtar rreth Planit Trump të Paqes, që “legjitimon pushtuesin ose blerë sovranitetin”, Moska ka bërë përpjekje të sforcuara për të dalë nga izolimi perëndimor si dhe për t’i rikthyer lavdinë datës 9 maj. Prandaj ka adresuar/testuar jo vetëm për homologët diktatorë, (Kinez, Korenë e Veriut, Iranian, Malit, etj.) por dhe disa vendeve të NATO/BE. Po ashtu, ndërsa: “ka shpallur armëpushim 3 ditor” (8; 9 dhe 10 Maj) Nr.2 i Rusisë, Medvedev, ka bërë një paralajmërim neo-fashist ndaj Ukrainës: “nëse sulmon Moskën gjatë festimeve të 9 majit askush nuk mund të garantojë që Kievi do të mbijetojë deri më 10 Maj”!

Nga ana tjetër, edhe Perëndimi është përgjigjur me mesazhe të forta për të refuzuar ftesën cinike, pra pjesëmarrjen në paradën e Ditës Staliniste të Fitores më 9 Maj. Kështu Komisionerja për Zgjerimin, ka paralajmëruar jo vetëm z. Vuçic: “8 maji 1945 dhe 9 maji 2025 janë dy data me vlera krejtësisht të ndryshme. Të shkosh në Moskë për të festuar me ushtrinë e Putinit, që vret njerëz në Ukrainë, është në kundërshtim të plotë me vlerat evropiane dhe Euroatlantike (BE & SHBA/NATO)”.

Së dyti, por, cilat janë vlerat dhe mësimet e nxjerra të kësaj ngjarjeje të lavdishme, si dhe kush janë disa nga mesazhet e forta për besimin te paqja, rendi global, demokracia funksionale?

80 vjet më parë, pra më 8 Maj 1945, në Berlin u nënshkrua akti i kapitullimit të Gjermanisë – Hitleriane. Pavarësisht festimeve dhe emërtimeve, si Dita (Staliniste) e Fitores pra 9 Maj, apo Data Euroatlantike e Fitores (8 Maj): “ajo që mbetet e përbashkët është data e triumfit mbi nazifashizmin, një nga makineritë më kriminale që ka prodhuar historia e njerëzimit”.

Pikërisht më 8 Maj 1945, Presidenti i SHBA-ve, Truman, i konfirmoi popullit amerikan dhe mbarë botës fitoren e koalicionit të antifashist. Në të njëjtën datë, 8 Maj 1945, Gjenerali Suprem i frontit perëndimor, babai i NATO-s dhe President i SHBA-ve, Eisenhower, u përcolli luftëtarëve të çdo vendi të koalicionit antifashist: “mirënjohjen për sakrificat, kurajën si dhe kontributin në gjunjëzimin e bishës nazifashiste”.

Prandaj 8 Maji, meriton të përkujtohet si fundi i një lufte çnjerëzore/ferri që zgjati 5 vjet, që preku 80 % të popullsisë së globit dhe që mori jetën e rreth 60 milionë fëmijëve, burrave dhe grave nga mbarë vendet e botës. Kjo mbetet gjithashtu një datë nderimi për komandantet e lavdishëm dhe shtetarët e mëdhenj, si Churchill, Eisenhower, Zhukov, De Gaulle.

Së treti, pse më 8 Maj, edhe Shqipëria si pjesë e koalicionit të fitimtarëve, do duhet t’i bashkohet 32 vendeve të NATO-s dhe disa partnerë (p.sh Ukraina etj.), në celebrimin e kësaj ngjarjeje.

Pikë së pari, kjo datë do të shërbente për të kapërcyer kacafytjet qesharake (34-vjeçare) për datat 28-29 nëntor, dhe për më tepër, që 8 Maji do i jepte vlera shtesë përlules për të rënë, nderimit për sakrificat sublime të popullit si dhe rreshtimit të RSH me koalicionin e fitimtarëve.

8 Maji, kjo ngjarje e madhe do duhet të na shërbejë jo për

8 APO 9 MAJ, BETEJË MES VLERAVE PERËNDIMORE DHE KRIMEVE PUTINISTE!



të na ndarë sipas interesave partiake, por si “ilaç për të mjekuar plagët e kohezionit dhe solidaritetit kombëtar”, pra si urë bashkimi rreth flamurit dhe si fanar për të na ndriçuar në udhëtimin drejt perspektivës evropiane të Shqipërisë.

Ne, shqiptarët, kemi të drejtë të ndihemi krenarë më 8 Maj, pasi siç e ka përshkruar Kissinger në librin “Diplomacy”: “Shqipëria ishte një ndër të vetmet vende që u vetëçlirua pa prezencën e Ushtrisë së Kuqe, ose aleatëve perëndimorë”.

Prandaj, datën 8 maj e çmoj një “gjetje mjaft të mençur”, pra datë që Shqipëria e vogël t’i bashkohet koalicionit të madh të fitimtarëve për t’u përlur para kujtimit të dhjetëra miliona burrave dhe grave që dhanë jetën dhe bënë sakrifica të mbinatyrshme, për ta shpëtuar njerëzimin nga gjenocidi nazifashist.

Thënë këto, mbetet detyrim shtetëror, që çdo 8 Maj, të përulemi me mirënjohje ndaj atyre që dhanë jetën dhe të nderojmë emër për emër luftëtarët që u bashkuan pa dallim feje, krahine dhe bindjeje politike, kundër barbarisë nazifashiste duke mposhtur një ushtri qindra herë më të madhe, armatime dhe fuqi luftarake.

Përkundër propagandës bolshevike do duhet të përulemi me mirënjohje edhe para mijëra luftëtarëve që dhanë gjithçka, por u vranë, u burgosën dhe u persekutuan barbarisht nga regjimi E. Hoxhës, që u instalua pas çlirimit nga nazifashistët, 8 maj 1945 deri në mars 1991.

Në shtesë, për ta ndërlidhur me aktualitetin, po kujtoj, mesazhin historik të Presidentit Truman në 8 Maj 1945: “Ajo që na pret, pra ndërtimi i paqes, nuk është më pak e rëndësishme,

as më pak e vështirë, por Ne do ta ndërtojmë paqen, duke besuar dhe punuar së bashku, ashtu siç e arritëm këtë fitore historike”!

“Nëse harrojmë, e keqja përsëritet edhe më mizorisht”. Neo-Stalinistët e Kremlinit (që shkelin edhe mbi sakrificat e popullit rus dhe lavdinë në fitoren e Luftës II Botërore); Kim-Jong, Shtetet apo Organizatat Terroriste; ushtarët/pasuesit e Millosheviçit në Beograd apo Dodikët e droguar nga interesat e Kremlinit, jo vetëm po kërcënojnë sovranitetin e Ukrainës martire, paqen në Lindjen e Mesme, sigurinë dhe axhendën e integritetit të 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor, por po sfidojnë seriozisht vlerat themelore, interesat dhe fuqinë e Aleancës Euroatlantike (SHBA/NATO/BE).

8 Maji përmban mesazhe të forta për 32 vendet e NATO-s (përfshi RSH), që jo vetëm të mbështesin me deklarata diplomatike Ukrainën, SHBA/NATO, në këtë betejë “për jetë a vdekje me të keqen e përbashkët”, por të marrin përgjegjësitë/barrën, për të përmirësuar kohezionin, Institucionin e mos-harresës si dhe modernizuar sistemin e sigurisë në përballjen me neo-nazistët e rinj që po kërcënojnë më shumë se kurrë që nga Lufta II Botërore, interesat euroatlantike, vlerat demokratike dhe interesat jetike të qytetareve.

Prandaj, 8 Maji meriton të celebrohet si një ngjarje e lavdishme, me mesazhe të gjalla, të përbotshme dhe të përjetshme për mbarë njerëzimin: “Për lirinë, paqen, stabilitetin demokratik dhe vlerat themelore, duhet çdo ditë vigjilencë, përkushtim dhe sakrifica”!

GRATË QË THYEJNË KUFIJ: PUSHTETI DHE NDIKIMI I TYRE NË SHOQËRI

Luftarakja **Emmeline Pankhurst** dhe beteja e saj në kërkim të së drejtës për të votuar. Emmeline Pankhurst ka pasur një rol kyç dhe vendimtar në historinë e të drejtave të grave, veçanërisht në fushatën për të drejtën e votës për gratë në Britaninë e Madhe. Ajo ishte një udhëheqëse e njohur e lëvizjes sufrazhete dhe themeluese e organizatës Women’s Social and Political Union (WSPU) në vitin 1903.

Vazhdon me shkencëtarën **Marie Curie**, e cila deri më sot, është e vetmja që ka fituar çmime “Nobel” në dy fusha: kimi dhe fizikë.

Maria Montessori, metodat largpamëse mësimdhënëse të së cilës bënë revolucion në arsim.

Virginia Woolf, një nga mendjet më të mprehta dhe penat më brilante të historisë së letërsisë.

Coco Chanel, e cila përmbysi konceptet e elegancës femërore të kohës. Guximtarja **Amelia Earhart**, pilotja që bëri të pasionoheshin pas saj miliona njerëz.

Agatha Christie, mendja krijuese e mbi 80 romaneve dhe tregimeve, me më se dy miliardë kopje të shitura.

Golda Meir, e konsideruar si “pasionarja e sionizmit”.

Margaret Thatcher, Zonja e Hekurt.

Leni Riefenstahl, regjisore filmash e dokumentarësh: gjeniale për kontributin e saj në zhvillimin e teknikës së xhirimit të filmave.

Josephine Baker, një valltare e njohur ndryshe si Venusi i Zi, e cila ashtu si Mata Harri, u kthye në agjente spiunazhi.

Frida Khalo, piktorja meksikane e cila bëri art me dobësitë e saj e fizike.

Elizabeth II, mbretëresha me një jetë të tërë në funksion të monarkisë.

Simone Veil, e cila propozoi ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, i njohur në Francë me emrin Loi Veil.

Anne Frank, vogëlushja që me pafajësinë e saj dëshmoi me forcë krimet e rënda ndaj hebrenjve.

Mary Quant, me një prej kriimeve të famshme në mbarë botën, sa u përket veshjeve: minifundin.

Wangari Maathai, ambientalistja dhe aktivistja afrikane që arriti të mbjellë 30 milionë pemë në Afrikë dhe u siguroi punë një numri të jashtëzakonshëm grave.

Billie Jean King, tenisista që nuk toleronte pabarazinë mes gjinive në sport.

Malala Yousafzai, aktivistja e re palestineze, u shndërrua në simbol për të drejtat e studimit të fëmijëve kudo në botë, e vlerësuar me çmimin “Nobel për Paqen”.

Mbretëresha Teuta e Ilirisë, e cila u vu në krye të shtetit ilir dhe të ushtrisë së tij pas vdekjes së të shoqit, mbretit Agron, duke mbretëruar e komanduar në vitet 230-227 p.e.s. Ajo mori pushtetin në një moment të vështirë për popujt ilirë, të cilët



përballeshin me ambiciet për zgjerim të Republikës Romake. Teuta ishte një personalitet i rëndësishëm i historisë ilire. Ajo ishte një grua e zgjuar dhe largpamëse. Sundoi vetëm për tre vjet, por vepra dhe lavdia e kësaj gruaje ka triumfuar në shekuj. Për sa kohë që mbretëroi dhe komandoi, ajo luajti një rol të rëndësishëm historik në bashkimin dhe konsolidimin politiko-shtetëror, në përparimin ekonomik-kulturor dhe në fuqishmërinë ushtarake të Ilirisë.

Elena Gjika, ishte shkrimtare dhe publiciste rumune me origjinë shqiptare.

Ajo njihej me pseudonimin **Dora D’Istria**, sepse atëherë ishte shumë i vështirë pranimi i rolit të gruas në letërsi, politikë, drejtësi, diplomaci dhe profesione që ishin pronë e mendjes mashkullore. Në kohën kur jetoi, Elena u quajt Princesha e Kulturës Evropiane.

Shote Galica, jehona e së cilës jeton edhe sot. Luftëtare e shquar e çetave kryengritëse të Kosovës për çlirimin dhe bashkimin e të gjitha viseve shqiptare. Pas vdekjes së të shoqit Azem Galicës, vazhdoi luftimet në krye të çetës së tij. Nga masakrat e serbëve, ajo humbi 22 anëtarë të familjes. Në vitin 1927, ajo u vendos në Shqipëri, në Fushë-Krujë, vit kur edhe u nda nga jeta.

Marigo Posio, është vajza shqiptare që qëndisi shqiponjën dhe flamurin që ngriti Ismail Qemali në Vlorë, më 28 nëntor 1912. Ajo e qëndisi flamurin, duke u shënuar si një nga gratë e rëndësishme të historisë sonë.

Sevasti Qiriazi, luajti një rol të madh në arsimimin e grave. Ajo ishte nismëtarja e organizimit të arsimit shqiptar për femra dhe mori pjesë në ngritjen e shkollës së vajzave. Sevasti Qiriazi ishte gruaje e parë shqiptare që studioi në institucionin amerikan “Robert College”.

Eleni Qirici, ka qenë gruaje e parë shqiptare që aktroi në Hollywood. Ajo ishte një vajzë e bukur, me ëndrra që u bë e famshme në Hollywood dhe arriti majat e karrierës. Eleni e vinte gjithmonë në dukje faktin që ishte shqiptare.

Nënë Tereza, gruaje shtatvogël me një zemër të

madhe, derisa ishte gjallë, quhej “shenjtorë e gjallë”. Ndhimonte të varfrit, jetimët dhe të sëmurët. Ofronte dashuri dhe kujdes për të padëshruarit. Ishte shpresë për të zhgënjyerit.

Puna bamirëse që ajo ka bërë në lagjet e Kalkutës, qytetit më të varfër dhe më të populluar të Indisë, preku zemrat e njerëzve të të gjitha feve. Nënë Tereza ka qenë armike e zëshme e ndëshkimit kapital dhe kundërshtarë e fuqishme e abortit. Ajo e ka cilësuar abortin si “shkatërruesin më të madh të paqes”. Nënë Tereza ka takuar njëherë kryeministren e Indisë, **Indira Gandhi**, për të kundërshtuar një program sterilizimi, i cili do të frenonte rritjen e popullsisë indiane. “Të takosh Nënë Terezë do të thotë të ndjehesh krejtësisht e përlurur”, ka thënë Ghandi në atë rast.

Ikkal Çika, është gruaje e parë gazetare shqiptare dhe e para pronare grua e revistës ekonomike-letrare “Java”. Ajo hapi rrugën për fillimet e përfshirjes së grave në të gjitha fushat e jetës dhe dha një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e nivelit arsimor, kulturor, emancipues për gratë.

Vaçe Zela, ka qenë dhe mbetet ikona e këngës shqiptare. Zëri i saj i jashtëzakonshëm i mbushte me energji skenat. Ajo është e vetmja femër shqiptare që është nderuar sa ishte gjallë me urdhrin “Nderi i Kombit”, për vlerat e saj si artiste e shquar.

Inva Mula, sopranoja shqiptare me famë botërore, Inva Mula, ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e operave më prestigjioze, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë në arenën ndërkombëtare. Disa nga pjesëmarrjet e saj më të suksesshme në operat botërore mbeten: “Meede” (1996) në Francë, “La Scara” (2001) në Itali, e shumë e shumë të tjera.

Eliza Dushku, aktorja amerikane me origjinë shqiptare, Eliza Dushku, u bë e njohur në serialet “Buffy” dhe “Angel”, por ajo u bë e njohur me pjesëmarrjen e saj në filmat “True Lies”, “The New Guy”, veçanërisht në filmin horror “Wrong Turn”. Eliza ka realizuar edhe një film-dokumentar për viset shqiptare.

Dua Lipa, ishte vetëm 19 vjeç kur Dua Lipa publikoi këngën e saj të parë, “New Love” (2015), e cila i solli asaj famë në të gjithë botën. Që nga ajo kohë, këngëtarja me origjinë shqiptare nuk është ndalur asnjë çast, ndërsa cilësohet si një ndër zërat më të mirë të momentit.

Rita Ora, ka depërtuar në skenën muzikore pas publikimit të këngës “Hot Right Now” (2012), por me muzikë kishte filluar të merrej që në moshë të vogël. Ajo lançoi albumin e parë më 27 gusht të vitit 2012, ndërkohë që në çdo vit ka ngjitur shkallët e larta të karrierës muzikore.

Bebe Rexha, është me origjinë nga Dibra, ndërkaq njihet për dëshirën e saj për ta ruajtur kulturën shqiptare. Ajo ka ardhur dhe në Shqipëri, ndërsa shihet shumë shpesh duke folur shqip, duke pranuar edhe origjinën e saj për të cilën është shprehur se ndihet krenare.





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Maji i dëshmorëve nisi me një aktivitet sinjifikativ në Vajzë të Labërisë në bashkinë e Selenicës. Kompleksi memoristik i ri i Dëshmorëve të fshatit Vajzë në ditën e dëshmorëve në përkujtim të gjakut të dëshmorëve që priti shumë vizitorë nga Tirana dhe nga shumë vende të tjera në 5 majin e këtij viti. Dita-memorie e kujtesës për dëshmorët e Vajzës tregoi se dëshmorët nuk harrohen kurrë, pasi ata janë trupëzuar me historinë me flamurin dhe gjakun e derdhur për liri, ata janë frymëzimi atdhetar, emblemë e krenarisë dhe heroizmit. Në Vajzë kishte ardhur Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, zëvendësministri i MM dhe anëtar i komisionit, Enkelejd Joti përgjegjës nga zëvendësministrat për çështjet e dëshmorëve, Kryetari i Bashkisë Selenicë Nertil Ëngjëllush Bellaj, Prefekti i Qarkut Vlorë Plator Nesturi, ish-prefekti Flamur Mamaj, deputeti Vullnet Sinaj, Kryetari i SHKA “Vajzë” Irfan Birbilaj, Kryetar i SHAK “Labëria” dega e Tiranës, Kryetar i SHKA “Fushëbardha” Nexhip Onjea, kryetar i SHKA “Dukaj” Gazmend Allkaj, Kryetare e OKDA dega Selenicë Shefo Xhaferaj, kryeplaku i fshatit Vajzë Çlirim Fredi Hitaj, sekretari i Përgjithshëm i SHKA “Vajzë” Lefter Tahip Hitaj, kryetari për Dëshmorët dhe pasardhësit e Veteranëve të fshatit Vajzë Rait Refat Kasaj, Nënkrjetar i SHKA “Vajzë” Mitat Shahin Bellaj, Fatmir Kaba, etj. dhe të gjithë për shpërndarjen e certifikatave të dëshmorëve të rinj.

Fshati Vajzë kishte para pesë majit, 27 meteorë lirie që mbanin titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut”. Për tre vite u përgatitjen dokumentet e 12 dëshmorëve të rinj, ndërkohë që është fakt se ne nuk bëmë asnjë lloj zbulimi, por grumbulluam faktet, dokumentacionin që ishte në historikun dhe ish-muzeun e fshatit dhe të Vlorës, që gjendej në librin e birit të shquar të fshatit Vajzë, gjeneral Maliq Sadushi (ish-zv/MM i parë), i cili në librin e tij “Fshati ynë i mirë”, (2002), një libër-testament brezash që thotë: “Një numër jo i vogël patriotësh vajzotë janë ekzekutuar me pushkatim. Padrejtësisht këta patriotë nuk janë shpallur dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo padrejtësi duhet korrigjuar”. Këtë e dëshmojnë dhe 17 anëtarët e komisionit që hartuan të parin historik të Vajzës dhe që realizuan një dëshmi autentike. Në Departamentin e Dëshmorëve pranë MM-së nëpërmjet Prefektit të qarkut Vlorë u dërguan 12 dosje për 12 të rënë të fshatit Vajzë, me një volum rreth 1200 faqesh, që plotësonin kriteret e Ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”. Ajo që nuk u mundësua në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut, u mundësua në 80-vjetorin e fitores mbi fashizmin. Shpallja e dëshmorëve të rinj është sot një amanet i përmëshur, që flet për luftën, qëndresën, pathyeshmërinë, lumenjtë e gjakut që fshati Vajzë derdhi në themelet e lirisë. Dëshmorët i nderon gjithë bota pasi ata janë vetë historia e kombeve. Dëshmorët janë luftë, gjak dhe histori. Ky lapidar në Vajzë dëshmon historinë, pasi dëshmorët u flasin të gjallëve për të shkuarën, historinë, gjakun e derdhur. Në varrezat e fqinjëve tanë në Itali është shkruar ky epitaf: “O ju të gjallë, që vizitoni këto varreza: nëse nga ju nuk zgjatet e nuk rritet lavdia e atdheut, ne kot paskemi vdekur”. Historia e kombit përjetësohet pikërisht në lumenj gjaku për lirinë. Çurçilli i vlerësonte betejat si: “gurët kilometrikë më të rëndësishëm të historisë”. Krisma e betejave shqiptare, gjaku i derdhur lumë për lirinë e vendit, edhe gjaku i bijve e bijave të fshatit Vajzë shkruan lirinë shqiptare, pasi krisma e luftës antifashiste u njoh edhe nga tre fuqitë e mëdha të koalicionit antifashist botëror. Zëri i dëshmorëve të Vajzës dhe gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar është një zë i shenjtëruar, një zë që shkroi nder, krenari dhe lavdi në librin e artë të shqiptarizms. Është detyrim mbarëkombëtar për ditën e 5 Majit, ditën e madhe e njerëzve të pavdekshëm, që antifashistët e lavdishëm të shekullit



Atdheu përjetë mirënjohës!



XX, të nderohen bindshëm dhe me koshiençë të plotë, pasi sikurse gjithë shqiptarët, fshati Vajzë ishte fshati që e mbështeti luftën partizane me shpirt, ndau kafshatën e gojës me luftëtarët e lirisë. Bashkëpunëtorët e fashizmit, nuk kanë munguar dhe nuk do të mungojnë edhe në Shqipërinë tonë të dashur. Ata mohojnë gjakun e dëshmorëve, minimizojnë deri në shuarje LANÇ-in, kalkulojnë shifra e denigrojnë luftën antifashiste, edhe pse sovranin popull ka një shprehje të larë në dritën e diellit: “Kush nuk respekton të rënë, nuk mund të dojë as të gjallët”. Respekti dhe nderimi i të gjallëve për veprën e dëshmorëve është evident, sepse nën drejtimin e SHKA “Vajzë” e posaçërisht të kryetarit Irfan Birbilaj, kryesisë dhe Kryeplakut e pleqësisë janë gjendur ditë e natë që procedurat dokumentare për hartimin e dosjeve të bëheshin sipas ligjit. Sot është rasti të falënderojmë komisionin për statusin e dëshmorit të Atdheut e posaçërisht Ministrin e Mbrojtjes që iu përgjigj kërkesës sonë, duke zbatuar ligjin në mënyrë të përpiktë dhe duke shpallur me titullin e lartë Dëshmor të Atdheut 12 bijë e bija të fshatit Vajzë dhe që t’iu mundësohej vendosja e emrit në këtë lapidar lavdie gjithë atyre që gjakun e derdhën për Atdhe për Shqipërinë e lirë para 81 vitesh dhe më konkretisht: Këze Shahin Sulçaj (1898 – 25.12.1943), ishte nëna e dy dëshmorëve, u ekzekutua nga nazistët gjermanë në fshatin Vajzë.

Pesare Xhezo Kërroçaj (1906 – 30.1.1944) pjesë e grave antifashiste të fshatit Vajzë kapet në befasi dhe ekzekutohet me breshëri plumbash përpara shtëpisë së saj në Vajzë. Ferik Zagoll Bilbilaj (1930–30.11.1943) korrieri i çetës së fshatit, pionieri trim që ra nga plumbat e mitralozit fashist gjerman dhe u pre nga predha e mortajës, pranë Amonicës te pylli i Kuliut. Dalan Mehmet Kamberaj (1893-16.4.1943) u arrestua nga forcat italiane në kodrat e Ashamirit, në përëndim të fshatit, u shoqërua për në komandën fashiste italiane, duke u mbajtur i lidhur këmbë e duar, u arratis afër Tegesë, dhe tentoi largimin drejt formacioneve partizane fashistët hapën zjarr dhe e ekzekutuan me breshëri automatiku. Beqir Hasko Osmanaj (1898–28.1.1944) u kap nga fashistët e bashkëpunëtorët në përroin e madh në veri-perëndim të fshatit, iu dorëzua komandës gjermane, ku u torturua për disa orë e më tej e ekzekutua përpara kasolles së tij, në afërsi të shtëpive të Sulçajve në Nastasaj. Abdyl Hasko Osmanaj (1910–1944) u kap në Buduvenda të Vajzës nga gjermanët, të cilët e torturuan gati një ditë të tërë, duke i kërkuar të tregonte se ku ishin fshehur strehuesit e partizanëve dhe aktivistët e lëvizjes së fshatit dhe meqenëse nuk tregoi u ekzekutua me pushkatim nga gjermanët. Shaho Barjam Selimaj (1890 –28.1.1944) po kthehej në fshatin e tij të djegur e të plaçkitur nga fashistët dhe po kalonte rrugës nga Marovicit për në fshat, diktohet nga patrulla gjermane që shkonte me motoçikleta gjatë rrugës automobilistike nga Ploça përgjatë fshatit Vajzë. Gjermanët tentuan të kapnin, por ai u përpoq të largohej dhe për t’iu shmangur ndjekësve; gjermanët hapën zjarr pa paralajmërim, duke e lënë të vrarë në rrugën automobilistike afër ullinjve të Vajzës. Delo Mystehak Sulçaj (1929 – 30.11.1943) po zbriste nga mali i Beunit, fashistët dhe bashkëpunëtorët e njihnin Delo Sulçaj si pjesë e familjes të lidhur fuqishëm me luftën partizane e kapin në befasi tek mullinjtë e Vajzës, tek po zbriste në rrugë dhe kur po kalonte drejt përroit u kap dhe e ekzekutuan me pushkatim në afërsi të “Buza e Bletës” në Vajzë. Sadedin Sherif Hazizaj (1898–18.2.1944) ishte anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Vajzës; kapet në mënyrë tinzare, torturohet në mënyrë çnjerëzore si pjesëtar të LANÇ-it dhe si anëtar të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të fshatit dhe më në fund e pushkatojnë. Hito Zenel Hitaj (1830–1878), i ekzekutuar nga osmanët në mëhallën Karavog të fshatit Vajzë të rrethit të Vlorës; ka qenë prijës i çetës së Vajzës dhe pjesë e kryengritjeve kundër pushtuesve osmanë; i përket periudhës së LSHP pasi ka rënë në prag të LSHP më 1878. Resul Beqo Resuli/Onjea (1869–1897), me origjinë nga fshati Vajzë, (bazuar në historikun e fshatit Vajzë), dhe fshatit Fushëbardhë të Gjirokastrës ka rënë në Luftën e tretë për mbrojtjen e truallit shqiptar në Vilajetin e Janinës në mars të vitit 1897.

Azbi Nurçe Hitaj (1900-10.2.1945), ka ndërruar jetë nga torturat e tmerrshme fashiste në moshën 45 vjeçare. Azbiu kishte

tre vajza dhe që të tria kanë qenë partizane. Në shtëpinë e Azbi Nurçe Hitaj u krijua Këshilli Nacionalçlirimtar i Vajzës. Për këtë, si antifashist u arrestua, burgos, torturua për dy vjet, provoi torturat më çnjerëzore të nazifashistëve. Shtëpia e tij u shemb me predha topi, që rrafshuan shtëpinë prej guri, por nuk mund të shuajnë historinë. Në fund të nëntorit 1944 u kthye në fshat pothuaj i vdekur, me plagë të shumta torturash dhe që pas tre muajsh më 10.2.1945, në agun e lirisë ndërroi jetë nga plagët. Nuk vdiq nga mosha, por nga plagët e torturat e luftës. Fashistët i shkaktuan Azbi Hitaj plagë shumë të rënda në trup, por dhe goditje të rënda psikike, të cilat e sakatuan tmerrsisht, për të mos u kthyer më kurrë në gjendjen e mëparshme dhe që mbërriti në ditën e çlirimit të vendit pothuaj i vdekur dhe i pakallur. Është padyshim një prej heronjve të këtij fshati, është dhe do të ngelet në përjetësi dëshmor, pasi dosja e tij ka më shumë se njëqind faqe, dëshmi të ish-luftëtarëve të luftës antifashiste partizane. Ai do të ngelet përjetësisht në dokumentet e shtetit dhe si një kujtesë për fshatin Vajzë, një kujtesë për ndërgjegjen popullore edhe të atyre që mund të shkelin këtë të drejtë ligjore, hyjnore, morale e historike, edhe për ata që formulojnë e fabrikojnë të dhëna për hir “të pronësisë”. Por dëshmorët janë të kombit, janë të Shqipërisë. Gjaku i derdhur për Atdheun është gjithsesi në të gjitha epokat mbi gjithçka. Atdheu është i të gjithë shqiptarëve dhe maksima proverbiale popullore “e drejta zhytet por nuk mbytet” vonon por nuk harron, e vërteta gjithmonë triumfon. Të gjithë familjarët që erdhën në Vajzë këtë herë ishin pjesë e armatës që mbajnë lart idealin e dëshmorëve, Shqipërinë e lirë dhe të begatë ta transmetoni si amanet të shenjtë nëpër breza. Grupi organizator në Vajzë dhe Tiranë po përgatit librin për 39 dëshmorët e fshatit Vajzë “Yje mbi Beun”, përfshi dëshmorët e rinj të shpallur këtë 5 maj si trashëgimi e fshatit Vajzë, si dhe e brezave që do të vijnë, pasi vepra luftarake antifashiste e dëshmorëve të Vajzës do jetojë në përjetësi. Gjaku i dëshmorëve të lirisë, i bijve e bijave të fshatit Vajzë dhe mbarë kombit shqiptar mori vëmendjen edhe të strukturës më të lartë të Komisionit të Statusit të dëshmorëve dhe personalisht të Ministrin të Mbrojtjes, që shpërndau certifikatat e dëshmorëve të rinj të Atdheut dhe më konkretisht: Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Këze Shahin Sulçaj, Pesare Xhezo Kërroçaj, Beqir Hasko Osmanaj, Abdyl Hasko Osmanaj, Delo Mystehak Sulçaj, Sadedin Sherif Hazizaj, Shaho Barjam Selimaj, Hito Zenel Hitaj, Resul Beqo Resuli (Onjea), ndërsa dosja e Azbi Nurçe Hitaj, patrioti e luftëtar i flaktë që vdiq nga torturat fashiste, më 10.2.1945, është në proces dhe ne jemi të sigurt për shpalljen e tij dëshmor sipas gjithë procedurave e normave standarde të legjislacionit shqiptar për dëshmorët. Shpërndarja e certifikatave dhe dhënia e flamurit “Familje Dëshmori” është realizuar në ditën e dëshmorëve, më 5 Maj 2025, në Vajzë të Vlorës. Në proces të përgatitjes së dosjes për titullin dëshmor janë edhe Rrapo Ferhat Bellaj (1877-1920), i cili ka rënë në janar të vitit 1920, në moshën 43 vjeçare në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës, një nga ngjarjet më madhore të shekullit që vendoste fatet e shqiptarëve pas pavarësisë së Shqipërisë të 1912-tës, si dhe në proces është dhe Shefit Qamil Duka në luftën e madhe të Vlorës, ndërkohë që është edhe një ngjarje, një vrasje e dhimbshme gjatë LANÇ-it, ajo e partizanëve Vojsava Hitaj (e motra e Donikës dhe Habesë, që të dyja pjesë e formacioneve partizane) e bija e Azbiut dhe Manushe Hitaj (që ishte si një rast identik si i Ramize Gjebresës). Opinioni në Vajzë dhe jo vetëm ruan në kujtesë kohën e luftës kur në shtëpinë e Azbiut dhe tre vajzave të tij partizane ishte ngritur Këshilli Nacionalçlirimtar. Ruhët në kujtesë shtëpia e Azbi Hitaj që ia shembën fashistët me 12 të shtëna topi, Azbiu i burgosur e torturuar deri nga ana psikike, ky patriot e luftëtar i flaktë që vdiq nga torturat fashiste, më 10.2.1945, e bën rastin si një mungesë të theksuar të mohuar në dekada. Përgatitja dokumentare e dosjeve për të rënë është detyrim i gjithë strukturave që mbrojnë gjakun e të rënëve për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar në Shqipëri. Gjykojmë se e drejta dhe e vërteta, drejtësia do triumfojë dhe Azbi Hitaj dhe e bija në të ardhmen do të shpallen dëshmorë të Atdheut.

Kryetari i Komisionit të statusit “Dëshmor i Atdheut”, ai dhe Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu u shpreh para pasardhësve të familjeve të dëshmorëve, përfaqësuesve të institucioneve dhe banorëve të zonës me fjalë të zgjedhura: “...kjo nuk është thjeshtë një ceremoni nderimi, por një akt i drejtë moral dhe historik. Shpallja e 11 bijve të fshatit Vajzë “Dëshmorë të Atdheut”, është një borxh, që historia u ka atyre që nuk jetojnë më dhe që jetën e tyre nuk e lanë në rehati, por formësuan rezistencë, u bënë ballë sfidave të mjegullta të kohës që jetuan dhe dhanë frymën e fundit kurorëzuar me simbolin e Atdheut. Këtu në Vajzë, çdo pëllëmbë tokë është dëshmitare e përpjekjeve të përgjakshme për lirinë dhe dinjitetin. Vajza është një truall, ku trimëria ka gjetur imazhin e vet ndër breza, ku një copëz hartë Shqipërie e mundur nga luftëtar, ku hasim një përëndim të pazakontë trimash. Dhënia e statusit të “Dëshmorit të Atdheut” për njëmbëdhjetë të rënë të periudhave të ndryshme historike, sot është një premtim ndaj së shkuarës dhe historisë, për më tepër një përgjegjësi e re përballë sfidave, që koha na dikton. Obligimi ynë nuk mund të fillojë dhe të mbarojë te lapidarët apo certifikatat, por shumë më tepër se kaq, është një stafetë brezash. Vetëm kur flamuri krenar i dëshmorëve tanë të valojë si i barabartë mes të barabartëve në selinë e Bashkimit Evropian, do të ndjejmë veten të lehtësuar nga ky detyrim i yni ndaj këtij trualli dhe dëshmorëve tanë, për të qenë në lartësinë e idealeve të të rënëve dhe për të çuar më tutje amanetin e tyre për Shqipërinë. Mirënjohje dhe respekt për kontributin e paçmuar të të gjithë dëshmorëve që dhanë jetën për Atdheun. Kujtimi i tyre të jetë bekim i brezave që do të vijnë! Lavdi dëshmorëve të fshatit Vajzë dhe dëshmorëve të Shqipërisë!

Si njerëz, e kemi të vështirë të imagjinojmë një botë në të cilën nuk ekzistojmë. Jemi aq të mësuar me idenë e njerëzimit si specia dominuese në botë sa që harrojmë faktin se planeti Tokë ka ekzistuar shumë kohë para nesh dhe ka të ngjarë të jetë ende këtu shumë kohë pasi ne të kemi ikur.

Sigurisht, nuk ka asnjë mënyrë për të parashikuar se kur dhe si do të zhduket raca njerëzore, por tashmë ka disa zhvillime, si natyrore ashtu edhe të shkaktuara nga njeriu, që mund të paraqesin një kërcënim për mbijetesën tonë në planin afatgjatë.



Armët bërthamore

Të gjithë e dinë se armët bërthamore kanë potencialin të shkaktojnë shkatërrim të menjëhershëm - një shpërthim i vetëm mund të lërë mijëra njerëz të vdekur. Por lufta bërthamore mund të ketë edhe pasoja afatgjata.

Sipas ekspertëve Kennette Benedict dhe Nobuyasu Abe, shpërthimet bërthamore mund të shkaktojnë një “dimër bërthamor”, gjatë të cilit pluhuri dhe sulfatet parandalojnë që rrezet e diellit të arrijnë në Tokë.

Do të ishte shumë e vështirë të kultivohej ushqim gjatë një dimri bërthamor dhe mund të kishte zi buke të përhapur për vite me radhë. Kjo mund të kishte pasoja katastrofike për njerëzimin.



Armët biologjike dhe kimike

Armët biologjike dhe kimike mund të duken më pak të frikshme sesa kushërinjtë e tyre si armë bërthamore, por në fakt, aksesueshmëria e tyre do të thotë se ato përbëjnë një kërcënim të barabartë, nëse jo më të madh.

Ndërsa armët bërthamore janë të kushtueshme dhe të vështira për t'u prodhuar, si armët biologjike ashtu edhe ato kimike mund të prodhohen me një buxhet të kufizuar. Sipas ekspertes Angela Kane, të dyja kanë potencialin të shkaktojnë një katastrofë globale.

Këto armë janë edhe më shqetësuese për faktin se disa vendeve nuk u intereson që ato janë të ndaluara. Armët biologjike dhe kimike janë të dyja të paligjshme, por janë përdorur të paktën katër herë në 40 vitet e fundit.

Ndryshimi i klimës

Ndoshta kërcënimi më i dukshëm që duhet të përfshihet në këtë listë është ndryshimi i klimës. Ekspertët besojnë se deri në vitin 2100 ka një shans prej 90% që planeti të jetë 2°C (rreth 36°F) më i ngrohtë dhe një shans prej 33% që të jetë 3°C (rreth 37°F) më i ngrohtë.

Nëse nuk ndërmerret asgjë për të luftuar ndryshimet klimatike dhe planeti në fakt ngrohet me 3°C (37°F) deri në vitin 2100, pjesa më e madhe e Floridës dhe Bangladeshit do të jetë nën ujë dhe qytete të tjera të mëdha do të përmbyten.

Sigurisht, janë ndërmarrë disa veprime për të ngadalësuar ngrohjen globale, por kërkohen shumë më tepër përpjekje nëse duam të ndalojmë rritjen e temperaturave globale në këto nivele.

Rënia e ekosistemit global

Ne kemi nevojë për ekosistemin tonë global për gjëra të tilla si ajri, uji, ushqimi dhe strehimi. E megjithatë, që nga vitet 1950, aktivitete të tilla si shpyllëzimi e kanë bërë ekosistemin gjithnjë e më pak të banueshëm.

Një grup ndërkombëtar studiuesish ka përcaktuar nëntë “kufij planetarë” që lejojnë ekosistemin e botës të qëndrojë i qëndrueshëm, dhe njerëzit tashmë e kanë tejkaluar limitin e katër prej këtyre kufijve.

Sipas Maria Ivanova, profesoreshë e qeverisjes globale në Universitetin e Massachusetts, Boston, dhe Philip Osano, një

Kërcënimet më të mëdha afatgjata me të cilat përballet njerëzimi



bashkëpunëtor kërkimor në Institutin e Mjedisit të Stokholmit, ekosistemet e botës janë në rrezik të madh.

Bakteret rezistente ndaj antibiotikëve

Antibiotikët në të cilët mbështetemi aktualisht për të luftuar shumë lloje të ndryshme të infeksioneve bakteriale po bëhen gjithnjë e më pak të dobishëm, pasi lloje të caktuara të bakteve bëhen rezistente ndaj tyre.

Ky është një kërcënim shumë real, siç është vënë në dukje nga David Heymann, kreu i Qendrës për Sigurinë Globale të Shëndetit në Chatham House.

Nëse shkencëtarët nuk janë në gjendje të zhvillojnë antibiotikë të rinj, numri i njerëzve që vriten çdo vit nga bakteret rezistente ndaj antibiotikëve mund të arrijë në 10 milionë deri në vitin 2050.



Pandemitë globale

Në tetor 2018, Business Insider publikoi një artikull që renditi shpërthimin e përhapur të sëmundjeve si një nga kërcënimet më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi në të ardhmen afatgjatë.

Shpërthimi i pandemisë globale COVID-19 në fillim të vitit 2020 shërben si provë se ky kërcënim ishte shumë më afër nga sa mendohej më parë.

Edhe pse shpërthimi i COVID-19 nuk krahasohet me epidemitë e ditëve të kaluara (murtaja zhduku 15% të popullsisë së botës në dy raste), urbanizimi i dendur do të thotë se mund të ketë shpërthime më të rënda në vitet që vijnë.

Asteroidët

Edhe pse asteroidët mund të tingëllojnë si pjesë e fanta-shkencës, në fakt ato janë një kërcënim shumë real. Kur një asteroid goditi Meksikën 65 milionë vjet më parë, ai i zhduku dinosaurët nga faqja e Tokës.

Sipas Tim Spahr, CEO i NEO Sciences, një asteroid mjaftueshëm i madh për të shkaktuar një katastrofë globale ka të ngjarë të godasë Tokën një herë në 120,000 vjet.

Gjithashtu, sipas Spahr, një asteroid mjaftueshëm i madh mund të shkaktojë ftohjen e Tokës duke lëshuar grimca që bllokojnë dritën e diellit. Mund të ketë zi buke që do të vrasin qindra miliona njerëz.

Shpërthime supervullkanike

Kur shpërtheu supervullkani Toba në Indonezi rreth 74,000 vjet më parë, njerëzimi pothuajse u zhduk nga miliarda ton pluhur dhe sulfat të lëshuar në atmosferë.

Ndërsa është e pamundur që shkencëtarët të parashikojnë një shpërthim supervullkanik më shumë se disa javë ose muaj më parë, të dhënat sugjerojnë se ato ndodhin çdo 17,000 vjet.

Kanë kaluar 26,500 vjet që nga shpërthimi i fundit, dhe për këtë arsye jemi vonuar. Edhe pse mund të mos e shuajë racën njerëzore, një shpërthim supervullkanik do të vriste shumë njerëz dhe do të shkatërronte bujqësinë.

Inteligjenca artificiale

Shumë shkencëtarë janë dakord se inteligjenca artificiale që do të rivalizojë trurin e njeriut mund të jetë e pranishme në dekadat e ardhshme dhe është e mundur që makina më inteligjente se njerëzit do të na ndjekin.

Kjo përbën një kërcënim për njerëzimin sepse, sipas pesë anëtarëve të Institutit të së Ardhmes së Jetës, makinat me inteligjencë artificiale mund të projektohen për të shkatërruar jetë.

Për më tepër, edhe nëse makinat janë projektuar duke pasur parasysh të bëjnë mirë, gjithmonë ekziston mundësia që ato të mos ndalen para asgjëje për të arritur qëllimin e tyre, duke lënë pas shkatërrime.



Kërcënimet të panjohura

Ndoshta kërcënimet më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi sot janë ato për të cilat nuk jemi ende të vetëdijshëm. Ndërsa shkenca vazhdon të zhvillohet, do të shfaqen më shumë kërcënimet që as nuk mund të parashikohen ende.

Aftësia për të parashikuar katastrofat globale nuk ka qenë gjithmonë pika e fortë e njerëzimit. Për shembull, shumica e njerëzve nuk e parashikuan shpërthimin e bombës së parë bërthamore përpara se të ndodhte.

Nga ana tjetër, ka disa ngjarje që janë imagjinuar, por që shkencëtarët i kanë konsideruar shumë të pamundura për t'u ndodhur. Mundësia e zhdukjes masive të shkaktuar nga një shpërthim rrezesh gama nga një yll, për shembull.

Qendra e Personel Rekrutimit



do të rekrutojë kandidatë për studime në

**AKADEMITË USHTARAKE NË MODENA, ITALI,
2 (DY) KUOTA, NË DEGËN “GJITHARMËSH”**

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 14 maj 2025.

Informohu në: <https://www.mod.gov.al>

Bëhupjesë
Forcat E Armatosura
Karrierë Ushtarake
FASHqiptare